



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 579/2 Prot.

Tiranë, më 16.02 2023

V E N D I M

Nr. 23 dt. 16.02 2023

“PËR

MIRATIMIN E NDRYSHIMEVE NË RREGULLORET E PROGRAMEVE TË
STUDIMIT QË OFRON FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES”

Mbështetur në nenin 3 paragrafi 2, pika b, 33 paragrafi 3, 38 pika d të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 7 paragrafi 2 pika b, nenin 20 pika ë të Statutit të UST-së, në nenin 7 të Rregullores së UST-së, në Vendimin e Senatit nr.109, datë 22.07.2021 “Për miratimin e riemërimit dhe riorganizimit të njësisive bazë të FSHL”, të Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit nr.29 datë 07.10.2022 “Për frekuentimin e procesit mësimor sipas llojit të veprimtarive mësimore në auditor dhe ciklit të studimit” si dhe mbështetur në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr.262 prot., datë 24.01.2023 “Përcjellje e Draft-rregulloreve të programeve të studimit që ofron FSHL” si dhe në shkresën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes nr. 339/2 Prot., datë 03.02.2023 “Përcjellje relacioneve mbi ndryshimet në Rregulloret e departamenteve dhe Rregulloreve të programeve të studimit që ofron FSHL”, Senati Akademik në mbledhjen e datës 16.02.2023.

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në këto Rregullore:
 - Rregullore e Programit të Ciklit të Parë të Studimeve “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”;
 - Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të Studimeve “Master Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike”;
 - Rregullore e Programit të Ciklit të dytë të Studimeve “Master i Shkencave” në “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”;
 - Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimeve “Master i Shkencave” në “Shkenca Sportive”;
2. Ngarkohet Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes për zbatimin e këtij Vendimi. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Dixhitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore për publikimin e këtij Vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. AGRON KASA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEPARTAMENTI I SPORTEVE KOLEKTIVE

RREGULLORE MËSIMORE

PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË

BACHELOR

“SHKENCAT E LËVIZJES”

Miratuar me Vendim Senati nr. 23 datë 16.02.2023

SHKURT 2023

K R E U I

INFORMACION MBI PROGRAMIN E STUDIMIT

Neni 1 Objekti, baza ligjore

1. Rregullorja e Programit të Studimit të Ciklit të Parë, “*Bachelor*” në *Departamentin e Sporteve Kolektive*, përcakton kriteret dhe procedurat e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes për zhvillimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe të procesit mësimor në ciklin e parë.
2. Hartimi dhe miratimi i Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Parë, “*Bachelor*” në *Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes*”, mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, datë 05.10.2015, “Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), Rregulloren e Përgjithshme të UST-së, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive.

Neni 2 Të dhëna të përgjithshme

1. Të dhënat e përgjithshme për Programit të Studimit të Ciklit të Parë, “*Bachelor*” në *Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes* paraqiten në Tabelën 1.

Tabelën 1. Të dhëna të përgjithshme të Programit të Studimit

Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Fakultetin të Shkencave të Lëvizjes
Cikli i studimeve:	I parë
Lloji i programit:	Bachelor
Totali i Krediteve (ECTS):	180 ECTS
Kohezgjatja normale në vite	3 vite akademike
Forma e studimit:	Studime me kohë të plotë
Gjuha e studimit:	shqip
Departamenti përgjegjës	Departamenti i Sporteve Kolektive
Fakulteti përgjegjës	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes

brenda institucionit apo në institucione të
tjera të arsimit të lartë

Fakulteti Veprimtarise Fizike dhe
Rekracionit
Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit
Instituti i Kërkimit Shkencor në UST

Institucione të huaja të arsimit të lartë

Subjekte të tjera publike apo private

Neni 3

Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit

1. Objektivat formuese të programit të studimit:

Programi i studimit të ciklit të parë *Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes* i cili zgjat 3 (tre) vite akademike, ka si objektiv të formojë profesionistë të pajisur me shprehitë bazë (shkencore dhe profesionale) në fushën e Edukimit Fizik dhe Sporte është një profesion që mbështetet në botëkuptimin shkencave sportive dhe në një spektër të gjerë njohurish themelore dhe moderne. Në këtë profesion bashkohen njohja e gjerë e metodologjive moderne të sporteve të aplikuar me analizën e zgjidhjeve të problemeve konkrete të shendetit, rekreacionit dhe administrimit. Studenti aftësohet gjithashtu në përdorimin e teknologjisë dhe metodave moderne komplekse të teorisë së stërvitjes dhe aplikimit të tyre në mënyrë efektive.

2. Njohuritë dhe kompetencat e studentëve në përfundim të programit mësimor. Në përfundim të programit të studimit i diplomuari i ardhshëm pajiset me njohuri për:

- a) metodologjitë moderne të shkencave sportive së zbatuara;
- b) zgjidhjen e problemeve konkrete të përgatitjes fizike;
- c) përdorimin me efikasitet të teknologjinë e paisjeve për përgatitje fizike;
- d) përdorimin e teknologjisë kompjuterike në fushën e mirëqenies fizike dhe stërvitjes;
- e) zbatimin e projekteve të ndryshme në fushën e shkencave sportive;
- f) monitorimin e ecurisë së përgatitjes fizike të sportistit etj.

Neni 4

Veprimtaritë formuese të programit të studimit

1. Në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes veprimtaritë formuese që karakterizojnë programin e studimit përbëhen nga komponentët mësimorë të cilët ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime në auditor, ushtrime fizike në terren, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave mësimore të zhvilluara në auditor), studim individual (studim, punim relacionesh detyrash apo projektesh, përgatitje fizike etj), përgatitje për provime, përgatitje për provimin e diplomimit, veprimtari të tjera, si praktika mësimore, praktika në terren apo pranë subjekteve publike ose private.

2. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- a) *Lëndë bazë* të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
- b) *Lëndë karakterizuese*, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- c) *Lëndë ndërdisiplinore* dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme

dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup- lëndë me zgjedhje;

- d) *Lëndë plotësuese*, të fokusuar në përfitim të aftësive informatike dhe telematike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikën profesionale të zhvilluar pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;
- e) *Detyrime përmblylëse*, që lidhen me përgatitjen e punimit të diplomës/provimit të përgjithshëm përfundimtar.
3. Pësha që zë secila kategori e veprimtarive formuese në programin e studimit, e shprehur në përqindje të krediteve të alokuara, sipas llojit të programit, paraqitet në Tabelën 2.

Tabela 2. Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese në Programin e Studimit të Ciklit të Pare Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Levizjes.

Kategoria dhe Tipi i komponentit mësimor	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese	Kredite (ECTS)	Totali i krediteve/ përqindja
<i>(A) - LËNDË BAZË - përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme</i>	1. Shkencat sociale-humane dhe Sporti	16	33 ECTS / 18 %
	2. Anatomi Humane dhe Funktionale	7	
	3. Sjellja motore, Ak.Fizik dhe moshimi	10	
<i>(B) LËNDË KARAKTERIZUESE- përgatitje për disiplinën shkencore</i>	1. Bio-Shkenca dhe Edukim Shendetesor	12	96 ECTS/ 53%
	2. Atletikë	7	
	3. Basketboll	7	
	4. Fiziologji e Ushtrimit dhe Biomekanikë	16	
	5. Volejbol	7	
	6. Gjimnastikë	11	
	7. Pedagogji dhe didaktikë e Sportit	6	
	8. Futboll	7	
	9. Teori dhe Metodologji e stërvitjes sportive	12	
	10. Mjekësi sportive	11	
<i>(C) LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje</i>	1. Menaxhim në Sport	7	25 ECTS / 14 %
	2. Lëndë me zgjedhje	3	
	3. Sporte ndeshëse dhe kalitëse	15	
<i>(D) LËNDË PLOTËSUESE- Gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale</i>	1. Anglisht	4	21 ECTS / 12 %
	2. Metodologji e Kërkimit Shkencor	8	
	3. Terapi e Lëvizjes	5	
	4. Intership/ Praktikë profesionale	4	
<i>(E) DETYRIME PËRMBYLLËSE - Teza e diplomës</i>	1. Detyrime përmblylëse	5	5 ECTS / 3 %

K R E U II

PRANIMI I STUDENTËVE

Neni 5

Kriteret dhe procedurat specifike për pranimin e studentëve

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të parë *Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes*, kandidatët që:
 - Pranohen kandidatët që kanë kryer arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë kryer jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare.
 - Pranohen kandidatët që zotërojnë diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit, por pasi të jetë bërë ekuivalentimi i diplomës së fituar në vendin e huaj nga MAS.
 - Pranimi në programin “Bachelor” është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm dhe që plotëson:
 - Kriterin e meritës (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - Kriteret e vendosura për konkursin e pranimit. (testet e miratuara nga Senati i UST-së dhe të shpallura në Web-in zyrtar të universitetit).
 - Kushtet shëndetësore sipas Kartelës Mjekësore të miratuara nga UST-ja dhe të shpallura në Web-in e UST-së.

Neni 6

Procedurat për pranimin e studentëve

1. Studimet në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes mund të ndiqen nga shtetas shqiptarë, shqiptarët etnikë jashtë kufijve shtetërorë si dhe nga çdo shtetas i huaj, në bazë të kriterëve të përcaktuara nga MAS, Statuti dhe Rregullorja e përgjithshme të UST-së.
Pranimi në programet e studimit "Bachelor" në FSHL bëhet duke respektuar udhëzimet e ministrisë përgjegjëse të arsimit si dhe procedurën e përshkruar në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Përgjithshme të UST-së, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive si dhe këtë rregullore.
2. Në programet e studimit të ciklit të parë të Bachelor pranohen kandidatët që kanë përfunduar arsimin e mesëm të përgjithshëm apo profesional dhe kur kanë përfunduar jo më pak se 12 vjet shkollë në ciklet parauniversitare. Pranohen edhe kandidatët që kanë marrë një diplomë të shkollës së mesme jashtë vendit. Për këtë kategori kërkohet që të jetë bërë ekuivalentimi i

- diplomës së fituar prej tyre në vendin e huaj nga komisioni përkatës në MAS.
3. Pranimi në programet e studimit të ciklit të parë është i mundur për çdo kandidat që ka përfunduar me sukses ciklin e arsimit të mesëm si më sipër, si dhe që plotëson:
 - a. **Kriterin e meritës** (mesatare e shkollës së mesme) e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.
 - b. **Kuotave të paracaktuara.**
 4. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi të ciklit të parë në UST, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

Neni 7

Transferimi i studimeve

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UST apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë publike ose private, vendase ose të huaja, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera, sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren e Pergjithëshme dhe ato të Transferimeve. Programet e studimit dhe detyrimet e shlyera në institucione të tjera njihen dhe ekuivalentohen nga pikpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Njohja dhe ekuivalentimi i krediteve bëhet nga Departamenti i Sporteve Kolektive ose Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes pranë të cilit është paraqitur kërkesa për transferimin e studimeve.

Neni 8

Kushtet për transferimin e studimeve

1. Transferimet bëhen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përrafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik.
2. Studenti mund të transferojë studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UST-se apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:
 - a) ka fituar jo më pak se 30 kredite në programin përkatës të studimit, nga vjen;
 - b) plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga Departamenti i Sporteve Kolektive ose Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes;
 - c) në të kundërt, ai mund të fillojë studimet nga e para, duke ndjekur procedurat në hyrje në përputhje me kornizën ligjore në fuqi;
3. Njohja e plotë e krediteve të fituara nga një student që transferohet, bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Pergjithëshme në Rregulloren e Transferimeve në UST, si dhe në këtë rregullore.

Neni 9 Procedurat për transferimin e studimeve

1. Procedurat për transferimin e studimeve në ciklin e parë fillojnë në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik.
2. Kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes dokumentacionin e nevojshëm, të pëcaktuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren e Transferimeve në UST.
3. Studenti që transferohet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, listën e notave, planin e plotë të programit dhe syllabuset përkatëse duhet t'i dorëzojë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin.
4. Sekretaria mësimore e Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ndjek të gjithë praktikën sipas udhëzimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin mbi procedurat e aplikimit të kandidatëve.
5. Departamenti i Sporteve Kolektive ose Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes mund të vendosin kritere specifike për pranimin e transferimit të studimeve, të cilat miratohen në Dekanat dhe Rektorat. Kriteret e pranimit shpallen publikisht me fillimin e procesit të transferimeve në Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes.
6. Në rastet e transferimit të studimeve nga brenda apo jashtë vendit, në vitet e ndërmjetme të programeve të studimit, brenda të njëjtit cikël, studentët duhet të plotësojnë kriterin e notës mesatare të përcaktuar me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave të vitit akademik që studentit është pranuar në institucionin e arsimit të lartë, duke filluar nga viti akademik 2016-2017 dhe në vijim.
7. Studenti mund të transferojë studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UST apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:
 - a) ka grumbulluar nga Matura Shtetërore sasi pikësh më të larta se pragu minimal i pikëve që është arritur në programin e studimit të kërkuar në vitin përkatës.
 - b) ka fituar jo më pak se 30 kredite në programin përkatës të studimit, nga vjen.
 - c) Plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga njësitë bazë ose njësia kryesore e UST;
 - d) Në të kundërt, ai mund të fillojë studimet nga e para, duke ndjekur procedurat në hyrje të përcaktuar në kreun II të kësaj rregulloreje.
8. Kriteret dhe procedurat e njohjes së krediteve të fituara përcaktohen në rregulloren e njësisë baze ose kryesore në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, aktet e tjera nënligjore dhe këtë rregullore. Këto kritere bëhen publike përpara fillimit të aplikimeve për transferim të programit të studimit.
9. Vendimi për njohjen e plotë të krediteve të fituara nga një student që transferohet, i takon komisionit ad-hoc të propozuar nga Departamenti i Sportit Kolektive dhe të miratuar nga Dekani i Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes.

Neni 10

Njohja e krediteve

1. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve të ciklit të parë Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes bëhet nga Departamenti i Sporteve Kolektive, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e përgjithshme dhe ato të Transferimeve në USP, si dhe në këtë rregullore.
2. Njohja e lëndëve/moduleve dhe krediteve bëhet duke patur parasysh kreditet e lëndës, programin e lëndës dhe notën e marrë.
3. Lënda ose moduli ekuivalentohet kur:
 - a) ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm me lëndën/modulin e programit të studimit ku transferohet;
 - b) trajton tema të njëjta ose të ngjashme dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70% të lëndës/modulit që zhvillohet në programin e studimit në UST.
4. Në funksion të numrit të krediteve të njohura përcaktohet viti ku do të rregjistrohet studenti, si dhe numri i lëndëve dhe krediteve që duhet të plotësojë studenti në përputhje me programin e studimit ku është pranuar.

Neni 11

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Studentët që kanë kryer një program studimi të ciklit të parë, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, në të njëjtin cikël studimi, në përputhje me kriteret e pranimi të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme dhe Rregulloren e Konkurseve të pranimi të UST, si dhe në këtë rregullore studimi.
2. Procedurat e aplikimit për program të dytë studimi bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Studentit i njihen kriteret e fituara në përputhje me kërkesat e Rregullores së Përgjithshme në UST, si dhe të kësaj rregulloreje studimi

KREU III

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 12

Organizimi i studimeve

1. Studimet në Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë. Viti akademik përfshin mësimdhënien, sesionin e provimeve, sesionin e mbrojtjes së diplomave. Mësimdhënia organizohet në dy semestra. Kohëzgjatja normale e një semestri është deri në 15 javë.
2. Organizimi i mësimdhënies, i sesionit të provimeve dhe i sesionit të mbrojtjes së diplomave, shprehet në strukturën mësimore, e cila miratohet dhe shpallet nga Rektori i UST në fillim të çdo viti akademik.
3. Programi i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, ofrohet në gjuhën shqipe.

Neni 13

Format specifike të mësimdhënies, provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studenti

1. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara, të pasqyruara në planet mësimore, në programet e lëndëve. Format kryesore të punës mësimore janë:
 - a) format e mësimit teorik e praktik, ku përfshihen: leksionet, seminarët, ushtrimet në klase, ushtrimet në terrenet sportive, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, provimet permbylëse, etj.;
 - b) format e kontrollit të dijeve, ku përfshihen: bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, provat ushtrimore, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, provimi i diplomes, etj.
2. Departamenti i Sporteve Kolektive mund të propozojë edhe forma të tjera të punës mësimore, që janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit, veçanërisht ato të kontrollit të dijeve të fituara. Propozimet për format e reja bëhen para fillimit të viti të ri akademik dhe pasqyrohen në planin mësimor të programit të studimit si dhe në programet e lëndëve (*syllabus-e*) së bashku

me informacionet për ngarkesën mësimore, për orët në auditor/jashtë auditorit, për frekuentimin/ndjekjen e programit dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve.

3. Format e kontrollit të dijeve (si punë laboratorike, provat ushtrimore, marrje/mbrojtje e detyrave, marrje/ mbrojtje e projekteve, reflektohen në grafikët përkatës të detyrimeve, të cilët hartohen nga Departamenti i Sporteve Kolektive.. Kalendarit i këtyre formave të kontrollit të dijeve shpallet jo më vonë se dy javë pas fillimit të semestrit.
4. Kontrolli i dijes së një lënde, e cila realizohet gjatë sesionit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet:
 - Provimit me shkrim;
 - Provimit me gojë;
 - Vlerësimit të nje projekti ;
 - Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt;
5. Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet duke përdorur sistemin shqiptar të vlerësimit nga 4- ra tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nota minimale kaluese është 5 (pesë).
6. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimit me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë.

Neni 14

Detyrimet specifike që lidhen me frekuentimin

1. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies së disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme e frekuentimit të tyre ndryshon në funksion të tipit të aktivitetit mësimor që realizohet, duke i klasifikuar pjesërisht të detyrueshme dhe plotësisht të detyrueshme.
 - i.* Frekuentimi i leksioneve si rregull nuk është i detyrueshëm (është fakultativ), ndërsa frekuentimi i seminareve dhe ushtrimeve është i detyrueshëm për t'u shlyer deri para provimit në masën jo më pak se 75% të numrit të seancave të zhvilluara.
 - ii.* Frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 75%.
2. Përcaktimet me të detajuara gjenden në Rregulloren e përgjithshme dhe në programin e lëndës.

3. Për formën e mësimit me frekuentim të detyrueshëm laboratorë, punë praktike dhe praktika mësimore, kur studenti me ose pa arsye nuk merr pjesë qoftë edhe në një seancë mësimi, departamenti përkatës i krijon studentit edhe një mundësi tjetër për të shlyer frekuentimin e detyruar para përfundimit të semestrit. Në rastet e përsëritjes së mungesave, studenti i ndjek ato në vitin pasardhës.

Neni 15

Kërkesat specifike për organizimin e praktikave mësimore

1. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës mësimore. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e kompanisë/institucionit pritës.
2. Gjatë kryerjes së praktikës mësimore, pedagogu përgjegjës që e drejton atë, mban lidhje me kompaninë/institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës mësimore, studenti përgatit një relacion për punën e kryer dhe dorezon vlerësimin e bere nga ana e kompanisë ku ai ka kryer praktiken. Mbi bazën e këtyre dokumentave komisioni i ngritur në departament vlerëson studentin. Vlerësimi bëhet me notë.
3. Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shlyen detyrimet për praktikën mësimore, Departamenti, mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në Departament) mund t'i japë të drejtën për rikryerjen e praktikës mësimore deri në fund të vitit akademik.

Neni 16

Plani mësimor

1. Tërësia e veprimtarive formuese shprehet në *Planin Mësimor*, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit Bachelor në Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilin parashtrihen në mënyrë të përmbledhur sa mëposhtë vijon:
 - a) Emërtimi i programit të studimit, viti akademik, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për të, fusha e studimit, kohëzgjatja normale e studimeve, forma e përmblylljes së studimeve, struktura mësimore e programit të studimit
 - b) Tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara në semestra dhe të renditura sipas semestrave.
 - c) Kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një discipline sipas veprimtarive formuese të saj (leksione/ ushtrime/ushtrime në terren/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte, etj.), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor, mënyra e vlerësimit të lëndës.
2. Hartimi/rishikimi i Planit mësimor bëhet sipas procedurës së përshkruar në Rregulloren e Përgjithshme të UST.

Neni 17
Programi mësimor i lëndës

1. Programi mësimor i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Në programin mësimor të lëndës jepet në formë të përmbledhur:
 - a) të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor; emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës;
 - b) njohuritë paraprake që duhet të ketë fituar studenti, objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvehtësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda;
 - c) përmbajtja e lëndës, e ndarë në leksione/ushtrime/seminare/ushtrime ne terren, e detajuar në tematika që zhvillohen sipas javëve mësimore;
 - d) përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave lëndore, temat e detyrave/projekteve të kursit;
 - e) forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse.
2. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës, ose grup titullarësh të lëndës, rishikohet nga Koordinator i programit të studimit në Departamentin e Sporteve Kolektive dhe miratohet nga drejtuesi i Departamentit të Sporteve Kolektive dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes.
3. Titullari i lëndës dhe stafi mësimdhënës, në përfundim të procesit mësimor, japin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozojnë ndryshime në programin e lëndës.

Neni 18
Programi mësimor i shkurtuar i lëndës

1. Programi mësimor i shkurtuar i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Në programin mësimor të shkurtuar të lëndës jepet në formë të përmbledhur:
 - a) të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor; emri i stafit mësimdhënës;
 - b) objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvehtësimi i lëndës;
 - c) programi i përmbledhur i lëndës;
 - d) mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë.
2. Programi mësimor i shkurtuar i lëndës hartohet nga titullari i lëndës, ose grup titullarësh

të lëndës, rishikohet nga Koordinator i programit të studimit në Departamentin e Sporteve Kolektive dhe miratohet nga drejtuesi i Departamentit të Sporteve Kolektive dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes.

3. Programet e shkurtuara të lëndëve të Programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në Fakulteti e Shkencave të Lëvizjes, si pjesë e rregullores së Programit të Studimit, i bashkëngjiten kësaj rregulloreje.

KREU IV

DIPLOMIMI I STUDENTËVE

Neni 19

Kërkesat specifike për diplomimin e studentit

1. Në përfundim të programit të studimit Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, studentët kanë të drejtë të diplomohen në fushën e studimit “Shkencat e Lëvizjes”.
2. Studimet e ciklit të parë “Bachelor “ në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes përmbillen me Provim të Përgjithshëm përfundimtar dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë “Bachelor” në “Shkencat e Lëvizjes”.
3. Studenti nuk mund të mbrojë tezën e provimit final pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.
4. Studenti, para mbrojtjes së provimit të përgjithshëm përfundimtar duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin.

Neni 20

Organizimi i Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar

1. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes”.
2. Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit organizon konsultime me studentët për tematika të ndryshme të programit të provimit sipas një grafiku të miratuar prej saj dhe të shpallur në mjediset publike.
3. Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përbërë nga pedagogë efektivë dhe të ftuar, të fushave që mbulon programi i provimit.
4. Anëtarët e komisionit propozohen nga njësitet bazë të cilët mbulojnë lëndët e përfshira në provimin e përgjithshëm, dhe miratohen nga drejtuesi i Fakultetit e Shkencave të Lëvizjes.

5. Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat/ lëndët që përfshihen në programin e provimit.
6. Njësitë bazë të përfshira në provimin e përgjithshëm përfundimtar hartojnë fondin e pyetjeve dhe i depozitojnë në Departament të pakten një javë para fillimit të sesionit të provimit.
7. Fondi i pyetjeve duhet të jetë rreth 10 herë më i madh se numri përkatës i pyetjeve që përmban teza në fushën përkatëse.
8. Tezat e provimit të përgjithshëm përfundimtar kompozohen nga anëtarët e komisionit, të cilët i përzgjedhin pyetjet nga fondi i krijuar në përputhje me peshën specifike të çdo fushe.
9. Provimi organizohet me shkrim dhe është i sekretuar.
10. Korrigjimi i tezës bëhet nga komisioni, i cili shënon pikët e fituara në faqen e sekretimit.
11. Heqja e sekretimit bëhet nga komisioni në prani të studenteve.
12. Rezultatet e provimit të përgjithshëm përfundimtar duhet të jepen brenda afateve të percaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të UST-se.
13. Studenti ka të drejtë të ballafaqohet me korrigjimin e provimit të tij.
14. Nëse gjatë ballafaqimit konstatohet se është bërë gabim gjatë vlerësimit, bëhet ndryshimi i vlerësimit dhe mbahet një procesverbal që i bashkëngjitet fletores përkatëse. Në përfundim të procesit të ballafaqimit, komisioni bën vlerësimin përfundimtar dhe plotëson fletën e provimit, e cila firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit.
15. Përgjigjet ruhen për një vit në arkivën e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes.

Neni 21

Diplomimi nëpërmjet Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar

1. Provimi i Përgjithshëm Përfundimtar organizohet në tri sesione; verë, vjeshtë dhe dimër, në përputhje me strukturën akademike si dhe duke respektuar procedurën e përshkruar në Rregulloren e Përgjithshme të UST.
2. Komisioni i diplomimit përbëhet nga 3- 5 (pesë) anëtarë.
3. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit.
4. Kur studenti vlerësohet me notë pozitive, Fakulteti e pajis studentin e sapodiplomuar me diplomën "*Bachelor*" në "*Shkencave e Lëvizjes*", të shoqëruar me Suplementin e saj.
5. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UST, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
6. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar, ai mund të rihyjë në provim brenda një afati kohor të caktuar, por pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi.
7. Gjatë periudhës kohore maksimale të përcaktuar kornizën ligjore në fuqi nga koha e

- përfundimit të studimeve të plota, diplomanti ka të drejtë të hyjë në provim deri në tre herë.
8. Nëse në të tre rastet diplomanti është vlerësuar nga komisioni me notë negative ose ai nuk paraqitet për të kryer Provimin e Përgjithshëm Përfundimtar brenda afateve maksimale, atëherë studenti humbet të drejtën e diplomimit.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 22

Kjo Rregullore e programit të studimit Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes e shtrin veprimtarinë e saj duke filluar nga viti akademik 2022-2023.

Neni 23

Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes është objekt rishikimi periodik. Rishikimi bëhet në fillim të vitit të ri akademik dhe synon përmirësimin dhe përditësimin e elementëve të ndryshëm të saj. Rishikimi bëhet mbi bazën e propozimeve që mund të vijnë nga Koordinatori i programit të studimit dhe Departamenti i Sporteve Kolektive, duke respektuar kuardin ligjor në fuqi, Rregulloren e Përgjithshme në UST. Propozimet shqyrtohen dhe miratohen në Departament dhe Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes dhe Rektoratit të UST-së.

Neni 24

Rregullorja e programit të studimit Bachelor në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes është miratuar në Dekanatin e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEPARTAMENTI I SPORTEVE INDIVIDUALE

Rregullore e Programit të Studimit
“Master Profesional”
“Trajner i Përgatitjes Fizike”

Miratuar me Vendim Senati nr. 23 datë 16.02.2023

SHKURT 2023

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i rregullores

Rregullorja e Brendshme e Programit të Studimit, "Master Profesional" në "Trajner i Përgatitjes Fizike" (MPTPF) vendos rregullat normative të funksionimit të Masterit dhe të marrëdhënieve që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e këtij Programi. Rregullorja përcakton misionin, strukturën e brendshme dhe mënyrën e funksionimit të Programit të Studimit, të drejtat dhe detyrimet e organeve drejtuese, të personelit akademik dhe administrativ, të studentëve, të bashkëpunëtorëve; raportet midis tyre; rregullat për pranimin e studentëve, për mësimdhënien, për kërkimin, për praktikën, për vlerësimin, për diplomimin, për publikimet, për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, për rekrutimin e personelit dhe parashikon sanksionet në rastin e shkeljes së rregullores. "Masteri Profesional" në "Trajner i Përgatitjes Fizike" (MPTPF) ka për qëllim thellimin e njohurive të marra në sistemin e studimit "Bachelor" në Shkencat Sportive, si dhe dhënien e njohurive të reja, për t'i pajisur studentët me njohuritë e nevojshme specifike në plotësim të nevojave të tregut të punës, të lidhura me sportin, dhe specifikisht për trajnerët e përgatitjes fizike.

Neni 2

Qëllimi i rregullores

Rregullorja ka si qëllim të sigurojë kuadrin e brendshëm juridik të nevojshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë së Programit të Studimit "Master Profesional" në "Trajner i Përgatitjes Fizike" / MPTPF.

Neni 3

Baza ligjore

Baza ligjore e kësaj rregulloreje është neni 102 i Kushtetutës, në zbatim të ligjit 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", VKM nr.123, datë 17.02.2010 "Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës"; VKM nr. 57, datë 29.01.2020, "Për dhënien e statusit të veçantë Universitetit të Sporteve të Tiranës si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e sportit në Republikën e Shqipërisë"; Vendimit nr. 418, datë 10.05.2017 të Këshillit të Ministrave "Për standartet, kriteret dhe procedurat për hapjen, riorganizimin, ndarjen, bashkimin ose mbylljen e institucioneve të arsimit të lartë dhe të degëve të tyre"; Vendimin nr. 41, 24.01.2018 të Këshillit të Ministrave "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë", i ndyshuar me VKM nr, 879, datë 18.12.2019, për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 41, dt. 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave; VKM nr. 531, datë 11.09.2018 "Për miratimin e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë".

Neni 4

Subjektet

Subjektet e kësaj rregulloreje janë organet drejtuese, personeli akademik dhe administrativ, komisionet, studentët e Masterit Profesional dhe bashkëpunëtorët e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes.

KREU II

MISIONI DHE VEPRIMTARIA E MPTPF-së

Neni 5

Programi i Studimit

- 5.1. Programi i Studimit MPTPF është cikël i dyte studimi në strukturën akademike të FSHL-së.
- 5.2. MPTPF-ja është shkollë **1 vjeçare (2 Semestra – 60 Kredite)** me kohë të plotë, e cila merr përsipër të ofrojë programe studimi për Diplomë të Ciklit të Dytë.
- 5.3. Për mbarëvajtjen e veprimtarisë së MPTPF-së kanë përgjegjësitë përkatëse Dekani i FSHL-së, Zv.Dekani dhe Përgjegjësit e Departamenteve.

Neni 6

Misioni i MPTPF-së

MPTPF-ja ka si mision: Të përgatisë specialistë të Stërvitjes Sportive, duke ju referuar kërkesave të larta të federatave sportive, në fushën e përgatitjes fizike: forcë shpejtësi, qëndrueshmëri, kordinacion dhe proprioception etj. Trajnerët e përgatitjes fizike që dalin nga ky Cikël i Dytë studimesh gjithashtu do plotësonin një vakum të vazhdueshëm të tregut të punës për specialistë të mirëfilltë. Në veçanti, të diplomuarit do t'i bëjnë një shërbim shumë të madh fushës së sportit kompetitiv (garues), si dhe do i shërbejnë sportistëve për një përgatitje të lartë fizike për garë dhe do të garantojë në të njëjtën kohë edhe shëndetin e një jetë cilësore për ata.

Neni 7

Funksionimi i MPTPF-së

- 7.1. Aspektet kryesore të funksionimit të studimeve në MPTPF janë: mësimdhënia cilesore e profesionale, dialogu akademik, lidhja e vazhdueshme me praktikën e stërvitjes sportive, duke nderthurur në raporte të drejta formimin teorik me atë praktik.
- 7.1.1. Veprimtaria mësimore zhvillohet në bazë të planeve dhe të programeve mësimore bashkëkohore të bazuara në modelet e shkollave analoge evropiane.

7.1.2. Veprimtaria kërkimore në MPTPF është e orientuar kryesisht në studimin e çështjeve të fushës të stërvitjes sportive të fokusuar totalisht në përgatitjen fizike dhe realizohet nëpërmjet projekteve të kërkimit në terren, kryesisht në ekipet sportive elitare.

Neni 8

Vendi i zhvillimit të MPTPF-së

“Masteri Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike” (MPTPF) zhvillohet në ambientet e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

Neni 9

Organizimi i MPTPF-së

“Masteri Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike” (MPTPF) realizohet në përputhje të plotë me statutin dhe rregulloren mësimore të UST-së, rregulloren e brendshme të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe bazohet në veprimtarinë pedagogjike e profesionale të 3 (tre) Departamenteve të Fakultetit.

Neni 10

Kriteret e pranimit

Në Programin e Studimit “Master Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike” (MPTPF) mund të regjistrohen vetëm personat që zotërojnë diplomë të ciklit të parë “Bachelor” (ose ekuivalente me të, sipas kuadrit ligjor në fuqi) në Shkencat e Lëvizjes ose Aktivitet Fizik për Shendet e Rekreacion, të fituar pranë Fakulteteve të UST-së, ose diploma të ngjashme të fituara jashtë tij. Ekuivalenca në këtë rast bëhet nga komisionet Ad- hoc që ngrihet nga Departamenti i Sporteve Individuale të FSHL-së i miratuar gjithmonë nga Dekani i Fakultetit.

Neni 11

Regjistrimet

Pranimet në “Master Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike” (MPTPF) bëhen sipas hapave më poshtë:

1- Regjistrohen fillimisht, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës “Bachelor”, studentët që kanë diplomë “Bachelor” në Shkencat e Lëvizjes dhe në Aktivitet Fizik për Shendet e Rekreacion, të fituar pranë FSHL dhe FVFR në UST.

2- Nqs pas pranimit të të gjitha kërkesave nga studentët, që kanë diplomë “Bachelor” në Shkencat e Lëvizjes ose në Aktivitet Fizik për Shendet e Rekreacion, të fituar pranë FSHL, FVFR pranë UST-së, ka ende kuota të lira, regjistrohen në vijim, sipas kërkesave dhe të renditur sipas mesatares së ponderuar të diplomës “Bachelor”, studentët e Universiteteve të ngjashme.

Studentet që vijnë nga jashtë shtetit, nga shkolla të sportit (të ngjashme me formim shkencat e lëvizjes, aktivitet fizik për shendet e rekreacion), do të trajtohen në varësi të lëndëve të

ekuivalentuara dhe mesatares respektive. Vendimi për këto raste i takon komisioneve Ad-hoc të ngritura nga Departamenti i Sporteve Individuale të FSHL-së.

Neni 12 Detyrimet

Ne Programin e Studimit “Master Profesional” në “Trajner i Përgatitjes Fizike” (MPTPF) kanë të drejtë të regjistrohen shtetas shqiptarë ose të huaj. Këta të fundit, duhet të përmbushin të gjitha detyrimet/kërkesat, që rrjedhin nga legjislacioni përkatës në fuqi i Republikës së Shqipërisë dhe detyrimet/kërkesat, që përcaktojnë rregulloret/urdhëresat e UST-së/FSHL-së.

Neni 13 Struktura e Studimeve përfshin

- 1-LËNDË BAZË – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme.
- 2-LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore.
- 3-LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe lëndë me zgjedhje.
- 4-LËNDË PLOTËSUESE – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale.
- 5-DETYRIME PËRMBYLLËSE – Provimi final.

Përqindja e këtyre disiplinave do të jetë sipas kriterëve të përcaktuara nga udhëzimet e MAS, si dhe standartet e institucioneve homologe të UST-së në Europë.

Neni 14 Disiplinat dhe kreditet

A.	LËNDË BAZË	6 Kredite	1 Lëndë
B.	LËNDË KARAKTERIZUESE	24 Kredite	2 Lëndë
C.	LËNDË NDËRDISIPLINORE/INTEGRUESE	18 Kredite	3 Lëndë
D.	LËNDË PLOTËSUESE	6 Kredite	1 Lëndë
E.	DETYRIME PËRMBYLLËSE	6 Kredite	1 Provim

Gjithsej 8 provime në 2 semestra, 60 kredite

Sasia e krediteve të grumbulluara nga çdo student në 1 vit është 60 kredite.

Emërtesat e lëndëve, objektivat dhe metodologjia e mesimdhënieve në, të paraqiten të detajuara në planin mësimor të Departamentit të Sporteve Individuale dhe në çdo syllab.

Neni 15 **Programet mësimore të (MPTPF)**

1. Për çdo lëndë hartohen programe mësimore, syllabet, të cilat përmbajnë:
 - emrin e pedagogut që e zhvillon lëndën, si dhe modulet e saj.
 - emërtimin e lëndës, si dhe modulet përbërëse të saj.
 - vitin/semestrin, kur zhvillohet, lënda.
 - numrin e orëve në auditor (leksione, seminare, ushtrime etj.)
 - numrin e krediteve;
 - cilës veprimtarie formuese i përket kjo disiplinë (A, B, C, D)
 - objektivat specifike të kësaj lënde.
 - temat kryesore dhe çështjet për çdo temë.
 - format dhe metodat e mësimdhënies.
 - format e vlerësimit të studentëve (provime me shkrim, verifikime të dijeve gjatë zhvillimit të lëndës etj.)
 - detyrimet e studentit për lëndën (frekuentimi, detyrë kursi, kolokiumi etj);
 - literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse.
2. Programet mësimorë hartohen nga titullari i lëndës, ose grup pedagogësh, shqyrtohen në departament dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit.
3. Në fillim të çdo viti akademik pedagogu harton syllabin e lëndës (konform programit të lëndës dhe udhëzimeve të MAS dhe Statutit të UST.

Neni 16 **Elementet e Mësimin në “Master Profesional” (MPTPF)**

Elementët kryesore të mësimin janë: leksionet, seminarët, mesimet praktike, ushtrimet, ushtrimet në terren apo palestër, punet laboratorike, detyrat me shkrim, kolokiumet, detyrat e kursit, praktikat profesionale, testimet e ndërmjetme, testimi final.

Departamenti i Sporteve Individuale me miratimin e Dekanit të FSHL-së, mund të përcaktojë edhe elemente të tjerë të punës mësimore, veçanërisht në fushën e stërvitjes sportive, apo të praktikave profesionale në palestra, stadiume, qendra stërvitore...etj.

Neni 17

Format e zhvillimit

Mësimi në “Master Profesional” “Trajner i Përgatitjes Fizike” zhvillohet në bazë grupi e kursi. Numri i studenteve për çdo grup dhe kurs përcaktohet duke u mbështetur në udhëzimet e MAS dhe Vendimet e Senatit Akademik të UST-së.

Departamenti operon duke u mbështetur mbi këto norma, por dhe në përputhje me mundesitë reale të mjediseve, paisjeve didaktike, stafit akademik etj, duke patur të drejtën e nje tolerance të pranueshme. Për raste të veçanta, ndryshimet mund të bëhen vetëm me miratim e Rektoratit, apo të Senatit, sipas rastit edhe të MAS.

Neni 18

Format e zhvillimit

Ndarja e studentëve në grupe fiksohet në regjistrat e vitit, të cilët janë dokumente zyrtare. Në to evidentohet zhvillimi i elementeve të mësimit nga pedagogët, si: lënda, forma e mësimit, tema, mungesat, java mësimore dhe firma e pedagogut përkatës, pa korigjime.

Neni 19

Detyrimet per frekuentimin

Mospjesmarrja e studentit në procesin mësimor, vlerësohet me mungesa nga pedagogu në regjistrin e shkollës, si dokumentacioni bazë i evidentimit të këtij procesi, administrohet nga Sekretaria Mësimore dhe Dekani, si dhe në evidencën personale të pedagogut, modeli i së cilës përputhet me modelin e ECTS-së. Nuk lejohet asnjë mospërputhje mes regjistrit, evidencës personale të pedagogut dhe syllabusit.

Neni 20

Detyrat lendore

Frekuentimi i elementeve të mësimit (Seminare, mësim praktikë, ushtrime, praktika mësimore etj.) është i detyrueshem në masën 75%, Leksione në masën 50 %, laboratorët 100%.

- Kur studenti ka marrë pjesë në më pak se 50% të Leksioneve ai nuk klasifikohet dhe perserit lenden vitin e ardhshem.
- Nese studenti ka ndjekur 50% të seminareve konsiderohet mbetës për vjeshtë, kur ka ndjekur nën 50% të lëndës ai nuk klasifikohet dhe përsërit lëndën vitin e ardhshëm.

- Kur në ushtrime apo mësim praktik studenti ka marre pjese në 65% të lëndës, nuk hyn në provimin e radhës dhe konsiderohet mbetës për vjeshtë.
- Kur ka marrë pjesë në më pak se 65% të ushtrimeve apo mesimeve praktike, ai nuk klasifikohet dhe përsërit lëndën vitin e ardhshëm.
- Praktikrat mësimore janë të detyrueshme deri në 80%, nën këtë përqindje, studenti nuk klasifikohet dhe përsërit lëndën vitin e ardhshëm.

Neni 21 **Organizimi i ores dhe mjediset**

Koha dhe Auditori i zhvillimit te mësimimit përcaktohet në orarin e mësimimeve. Ai hartohet nga Departamenti në fillim të çdo semestri dhe shpallet nga Sekretaria Mesimore para fillimit te çdo semestri. Orari duhet të respektohet plotësisht nga të gjithë studentët dhe pedagogët e Fakultetit. Orari mësimor ndërtohet mbi kritere pedagogjike, mbi bazën e harmonizimit të elementeve të mesimit dhe të shpërndarjes racionale të ngarkesës së studentit, për një përdorim sa më efektiv të terreneve sportive, laboratoreve dhe auditoreve ne dispozicion. Ndryshimet eventuale në orar bëhen vetëm përmes Sekretarisë Mësimore gjithmonë në bashkepunim dhe mirekuptim me Zv.Dekalin e FVFR-së. Kohëzgjatja e seancave mësimore është 60 minuta.

Neni 22 **Praktika Profesionale**

Studentët kanë të detyrueshme kryerjen e Praktikave Profesionale, që përfshihen në planin mësimor. Me fillimin e vitit akademik studentëve u komunikohet koha e kryerjes dhe programi i tyre. Studenti që nuk realizon programin e Praktikave Profesionale, i nënshtrohet rregullave të vendosura, si për të gjitha detyrimet e tjera. Praktikrat Profesionale zhvillohen pranë federatave sportive të ndryshme. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e kësaj praktike dhe ato të institucionit, ku kryen këtë proces. Gjatë kryerjes së Praktikës Profesionale, pedagogu që e drejton atë, ushtron kontroll të vazhdueshëm e mban lidhje me qendrën ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, pedagogu, pasi merr edhe mendimin e qendrës ku ajo është kryer, bën vlerësimin me notë, gjithmonë në përputhje të plotë me sistemin e ECTS-së.

Neni 23

Detyrimet ne Praktiken Profesionale

Në qoftë se studenti nuk merr pjesë në praktikat profesionale detyrohet t'i kryejë ato në vitet pasardhëse mësimore, në përputhje me periudhën e parashikuar në strukturën e atij viti akademik.

Neni 24

Kontrolli i nivelit te dijeve

Kontrolli i dijes së një lënde mund të bëhet:

- a) me shkrim
- b) me gojë
- c) i kombinuar (me shkrim e me gojë)

Mënyrat e kontrollit të dijes përcaktohet nga Departamenti përkatës që në fillim të vitit mësimor, mbështetur në planin mësimor, si dhe ne sistemin e ECTS-ve. Për lëndët, praktike format e provimit përfshijnë anën praktike dhe teorike, të vlerësuara me një notë të përbashkët.

Provimi me shkrim mund të jetë eliminues ose përcaktues. Provimi me gojë zhvillohet në formë pyetje – përgjigje (pa teze) ndërmjet komisionit të provimit dhe studentit.

Tezat e provimit me shkrim, në të gjitha rastet e kontrollit, hartohen nga titullari i lëndës së bashku me asistentin e tij (aty ku ka) dhe miratohen e firmosen nga Përgjegjësi i Departamentit.

Neni 25

Organizimi i Provimeve dhe Riprovimeve

Studenti fiton të drejtën të futet ne provimin e një lënde, kur ka shlyer detyrimet vjetore që lidhen me të, të parashikuara për shlyerje në planin mësimor.

Proçes verbali i shlyerjes së këtyre detyrimeve plotësohet nga pedagogu në përfundim të proçesit mësimor, para sezonit të provimeve dhe përbën listën përfundimtare të studentëve që futen në provim, e cila pasi rekordohet me sekretarinë mësimore dorëzohet në departament, i cili bën shpalljen para studentëve.

Emrat e studentëve, që kanë fituar të drejtën për të hyrë në provimin e lëndës paraqiten në fletën e provimit të lëndës përkatëse e cila nënshkruhet nga titullari dhe përgjegjësi i departamentit. Fletët e Provimit i dorëzohen komisionit të provimit ditën e provimit. Me përfundimin e provimit, kryetari i komisionit i vendos notat ne platformen elektronike të shkollës, si dhe printon një kopje të tyre duke

e firmosur së bashku me anëtarët e komisionit të provimit dhe i dorëzon ato në sekretarinë mësimore. Fletët e provimit, pas mbarimit dhe dorzimit të tyre duhet të ruhen në departament dhe në asnjë rast nuk lejohet ndërhyrja në to. Provimet dhe Riprovimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik, miratuar nga Dekanati. Datat e tyre shpallen jo më vonë se dy javë para fillimit të sezonit. Si në vlerësimin praktik dhe në atë teorik studenti, vlerësohet me sistemin me 100 pike, të cilat konvertohen me notë. Format e kontrollit të dijeve (Provimet), janë të ndërmjetme (testime apo provime të ndërmjetme) dhe provimi përfundimtar i Lëndës në sezonin përkatës.

Neni 26

Planifikimi dhe Organizimi mbi Vlerësimin e Provimeve

Provimet zhvillohen në orën e në datën e caktuar. Në raste të jashtëzakonshme të moszhvillimit të provimit ditën e caktuar, Dekani, me urdhër me shkrim e anulon, duke caktuar një datë të mëvonshme, e cila u bëhet e njohur studentëve.

Studentët merren në provimin e kursit së paku nga dy vetë: titullari i lëndës dhe asistenti përkatës, të cilët kanë zhvilluar lëndën. Nëse lënda nuk ka pasur asistent, Përgjegjësi i Departamentit cakton një asistent (ose pedagog) të një disipline të përafërt. Nëse titullari i lëndës ose asistenti i tij, për arsye madhore, nuk mund të marrë pjesë në provim, Përgjegjësi i Departamentit cakton (me shkrim) pedagogët që do t'i zëvendësojnë, vetëm pas miratimit përkatës të Dekanit.

Provimet me shkrim bëhen të sekretuara.

Ndalohet hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin edhe anëtarë të personelit universitar, me përjashtim të drejtuesit të Departamentit, të Dekanit dhe persona të tjerë të autorizuar me shkrim nga Dekani, për të kryer kontroll.

Ndalohet mbajtja e celulareve në provim dhe studentet që përdorin në provim forma të mjeteve të palejueshme, apo komunikojnë me studentët e tjerë dhe pengojnë zhvillimin normal të provimit, përjashtohen nga provimi.

Kohëzgjatja e provimit teorik është jo më shumë se 3 orë.

Nëse është shpërndarë teza e provimit, asnjë student nuk lejohet të futet në provim pas këtij momenti.

Nota kaluese me e ulët është 5-së ose 45-54% të pikëve.

Studenti vlerësohet kalues nëse është kalues në të gjitha modulet e lëndës. **Nota e lëndës përcaktohen sipas formulës:**

Nota e Lëndës = (Nota e modulit 1 x kreditet e moduli) + (Nota e modulit 2 x kreditet e modulit) +(aq module sa ka lënda) pjestuar me shumën totale të krediteve të lëndës.

Kur nota del me shifra dhjetore, ne qofte se kjo shifer eshte me e madhe se 5, pra 6-të e lartë, nota e lëndës kalon 1 njësi me lartë (psh.5.6 nota del 6)

Neni 27

Kriteret dhe Dokumentacioni

Studentit nuk i lejohet të hyjë për të dytën herë në provimin e një lënde brenda një sezoni.

Studenti nuk mund të hyjë në të njëjtën ditë në dy provime në lëndë të ndryshme.

Studenti paraqitet në provim me kartë identiteti, ose me kartën e studentit, dhe në mungesë të tyre, me dokument identifikimi (pasaportë, leje drejtimi).

Studenti përsëritës ka këto të drejta dhe detyrime:

- I njihen detyrimet e shlyera,
- Duhet të shlyejë detyrimet e reja (kur ka), që lindin për shkak të ndryshimeve në planin mësimor (kurrikulës).

Neni 28

Shkeljet e Etikes

Studenti përjashtohet nga shkolla:

- Kur bën shkelje të rënda etiko – morale brenda dhe jashtë mjediseve të UST-së (kur dhunon figurën e pedagogut, kur kryen akte vjedhjeje, akte të rënda rrugaçërie, kur dënohet me vendim të formës së prerë nga gjykata). Në këtë rast vendimi merret nga Rektorati.
- Mbas mbarimit të afatit të masës së përjashtimit studenti ka të drejtë ti rikthehet vazhdimit të studimeve në pikën e ndërprerjes me kusht që të mos kalohen afatet e studimit të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 29

DIPLOMIMI

Në përfundim të ciklit të dytë të studimeve (MP), studentët kanë të drejtë të diplomohen me diplomë “Master Profesional”. Diplomimi bëhet me provim final.

Dekanati në bashkëpunim me departamentin përkatës, brenda 4 javëve të fundit të semestrit të dytë miratojnë tezat e provimit përfundimtar. Komisioni i provimit final përbëhet nga jo më pak se 3 pedagogë. Studenti që rrëzohet në provimin final, ka të drejtë të paraqitet në provimet e sezonin të ardhshëm.

Neni 30

Pajisja me Dokument Diplome

Studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e planit mësimor e ka kaluar me sukses provimin final të “Master Profesional”, pajiset me diplomë përkatëse, të shoqëruar me fletën e notave të fituara gjatë studimeve, si dhe me suplementin e diplomës, sipas standartit të sistemit të ECTS-ve.

Diploma plotësohet me shkrim të qartë, me bojë teknike dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, si dhe nga Rektori i UST-së. Për secilin prej tyre shënohet emri mbiemri, grada dhe titulli shkencor. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e UST-së.

Neni 31

Rregullat e Tërheqjes së Diplomes

Tërheqja e diplomës bëhet personalisht nga i diplomuari, kundrejt nënshkrimit e evidentohet në regjistrin përkatës. Nëse prania e të diplomuarit është objektivisht e pamundur, tërheqjen e diplomës mund ta bëjë një nga pjestarët e familjes, pasi të jetë pajisur me një prokurë të posaçme, duke u paraqitur edhe me letërnjoftimin e tij.

Nëse diploma nuk është plotësuar në rregull, i interesuari duhet të mos e tërheqë atë dhe të kërkojë pajisjen me diplomë të rregullt. Rektorati në asnjë rast nuk lëshon dublikatë të diplomës, edhe në rastin kur ajo merret e parregullt nga sekretaria, kur i humbet origjinali, ose i dëmtohet, duke iu bërë e papërdorshme. Lejohet vetëm dhënia e listës së notave të fituara, suplementi i diplomës pasi nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit. Nënshkrimet e tyre vërtetohen me vulën e Fakultetit.

Neni 32

Të Drejtat e Detyrimit të Studentit në “Master Profesional” “Trajner i Përgatitjes Fizike”

Studenti i ciklit të dytë të studimeve MPTPF ka të drejtë:

- Të përdorë pajisjet e shkollës, sipas rregullave përkatëse, për të realizuar programin mësimor dhe punën e programuar në aktivitetin e tij shkencor, bibliotekën e mjediset sportive dhe kulturore të UST-së.
- Ka të drejtë të zgjedhë dhe të zgjidhet në të gjitha organet drejtuese të UST-së, në përputhje me të ligjin 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.
- Të përfaqësohet në Senatin e Akademik, në përputhje me rregulloren përkatëse të këtij organi.
- Të organizohet në shoqata të ndryshme jo politike, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore përkatëse.
- Të përfitojë bursë studimi, brenda ose jashtë shtetit, kur plotëson kushtet e përcaktuara me Vendim të Këshillit të Ministrave, të Senatit e në Marrëveshje Ndërshtetërore ose Ndëruniversitare.
- Të përfitojë shpërblime të veçanta, që administrohen nga UST-ja, sipas kriterëve të caktuara nga Senati.
- Me leje të Dekanit ka të drejtë të ndërpresë studimet deri në 1 vit. Mbi 1 vit bëhet me leje të Rektorit të UST-së.

Studenti ka të drejtë të ankohet për shkelje të rregullave të zhvillimit të provimit, ankesa paraqitet me shkrim në Dekanat, ose Departament brenda 24 orëve mbas shpalljes së rezultatit të provimit.

Dekani i FSHL-së, pasi verifikon shkeljet e reklamuar me Përgjegjësin e Departamentit e me komisionin e provimit, merr vendim të formës së prerë. Në rast se ankesa është e drejtë, Dekani vendos anulimin e provimit e ribërjen e tij për këtë student në një datë të veçantë, jo më vonë se tre ditë pas përfundimit të sezonit të provimeve. Vendimi i tij bëhet i njohur brenda 5 ditësh nga dita e ankesës. Në këtë rast në komisionin e provimit caktohet edhe një përfaqësues nga Dekanati.

Studenti është detyruar:

- Të njohë me hollësi rregullat e shkollës e detyrimet e saj dhe të jetë i vetëdijshëm për zbatimin e tyre, në të kundërt, shkolla nuk mban përgjegjësi për pasojat që mund të rrjedhin nga mosnjohja e tyre.
- Të zbatojë të gjitha rregullat, që rrjedhin nga Statuti i UST-së, nga kjo rregullore dhe nga çdo akt tjetër ligjor e nënligjor për Arsimin e Lartë.
- Të shlyejë të gjitha detyrimet e përcaktuara në planin mësimor e në programet e lëndëve.

- Të mbajë përgjegjësi, për shkeljet e rregullave të shkollës nga ana e tij.
- Dëmi material që ai mund të ketë bërë, ç'dëmtohet me masën që e gjykon Rektori/Dekanati/Administratori.

Neni 33

Tërheqja e diplomës

Dorëzimi i diplomave bëhet me ceremoni, në të cilën marrin pjesë autoritetet drejtuese dhe stafi pedagogjik mësimor – shkencor i FSHL-së dhe UST-së.

Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet çertifikata “Medalje e Artë”. Për studentët që, gjatë studimeve kanë marrë mbi 80% të notave 10 (dhjeta) dhe pjesën tjetër vetëm 9 (nënta), jepet çertifikata “Student i Shkëlqyer”.

Për çdo vit mësimor emrat e studentëve të sipërpërmendur evidentohen në “Librin e Nderit” të UST-së.

Në përfundim të programit të studimit, studenti pajiset me diplomë, “Master Profesional” “Trajner i Përgatitjes Fizike” (MPTPF) të firmosur nga Dekani i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe nga Rektori i UST-së. Gjithashtu, Studenti pajiset me Certifikatë të “Trajnerit të Përgatitjes Fizike” nga Federata Sportive përgjegjëse për disiplinën që i përgjigjet specilitetit të ndjekur nga studenti.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES

RREGULLORE

E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

MASTER I SHKENCAVE NË
“MËSUESI NË EDUKIMIN FIZIK E SHËNDETËSOR”

Miratuar me Vendim Senati nr. 23 datë 16.02.2023

SHKURT 2023

KREU I

INFORMACION MBI PROGRAMIN E STUDIMIT

Neni 1

Objekti, baza ligjore

1. Rregullorja e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor", përcakton kriteret dhe procedurat e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes për zhvillimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe të procesit mësimor në ciklin dytë.
2. Hartimi dhe miratimi i Rregullores së Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor", mbështetet në **Ligjin Nr. 80/2015**, datë 05.10.2015, "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Përgjithshme të UST, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe në Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit.

Neni 2

Të dhëna të përgjithshme

1. Të dhënat e përgjithshme për Programin të Studimit të Ciklit të Dytë, "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor", paraqiten në Tabelën 1:

Tabela 1. Të dhëna të përgjithshme të Programit të Studimit:

Emërtimi i programit të studimit	Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor
Cikli i studimeve	I dytë
Lloji i programit	Master i Shkencave
Totali i Krediteve (ECTS)	120 ECTS
Kohëzgjatja normale në vite	2 vite akademike
Forma e studimit	Kohë të plotë
Gjuha e studimit	Shqip
Departamenti përgjegjës	Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit
Fakulteti përgjegjës	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes

Struktura të tjera bashkëpunuese brënda UST^{së}: Departamenti i Sporteve Kolektive, Departamenti i Sporteve Individuale, FVFR, ISKSH, FSHR.

Institucione të huaja të arsimit të lartë	N/A
Subjekte të tjera publike apo private	N/A

Neni 3

Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit

1. Objektivat formuese të programit të studimit:

Ky program studimi synon përgatitjen dhe formimin e mësuesit specialist në lëndën e edukimit fizik e shëndetësor me njohuri dhe aftësi të thelluara në fushën e Edukimit Fizik dhe Shëndetësor i aftë për kërkim shkencor gjithashtu në fushat e lartpërmendura.

Programi i studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor", i cili zgjat 2 (dy) vite akademike, ka si objektiv plotësimin dhe thellimin e formimit të të diplomuarve në "Bachelor" me shprehuri bazë shkencore dhe të avancuara në fushën e edukimit fizik dhe shëndetit.

Programi operon dhe mbështetet në katër kolona bazë.

- I. Njohuri bazë teorike në fushat e pedagogjisë, didaktikës, kërkimit shkencor të cilat lehtësojnë komunikimin midis tyre;
- II. Një grupim lëndësh të fushës karakterizuese;
- III. Një grupim lëndësh të disiplinave integrale dhe ndërdisiplinore të cilat plotësojnë studentin me njohuri plotësuese për tu aftësuar si profesionist e kërkues shkencor në fushën e edukimit fizik e shëndetësor;
- IV. Një grup të gjërë lëndësh në teknologjitë e aplikuar në fushën e edukimit fizik dhe shëndetit të lidhura me zbatime të shumta në aspektet e mësimdhënies dhe të nxënies që kanë nevojë për njohuritë bazë teorike të këtij programi dhe që mbështeten nga lëndët e grupimeve II) dhe III) më sipër;
- V. Viti i parë konsiston në dhënien dhe konsolidimin e njohurive bazë I) dhe vazhdon me kurset e 3 grupimeve të tjera sipas një rradhe që respekton përmbajtjen dhe varësinë e tyre nga njëri-tjetri, Edukimi vazhdon me zbatimin njohurive të fituara në praktikën profesionale dhe punimin e tezës së diplomimit. Si rregull teza e diplomimit është e lidhur me lëndët e grupimeve II) dhe III) dhe në raste të veçanta me ato të grupimit IV), kur punimi ka karakter të mirëfilltë zbatues dhe është i lidhur me një zbatim specifik e konkret të lidhur me fushën e edukimit fizik e shëndetësore;

Programi synon të aftësojë studentët me teknikat moderne të mësimdhënies e të nxënës gjithashtu në zgjidhjen e problemeve nëpërmjet kërkimit në fushat e edukimit fizik dhe shëndetit, të cilat nuk mund të bëhen me anën e programeve të tjera profesionale.

Synohet që studentët të zhvillojnë idetë dhe aftësitë e tyre në përballje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e problemeve të fushës së shëndetit nëpërmjet edukimit fizik në jetën reale.

Një peshë të ndjeshme në program zë puna e pavarur e studenteve, projektet, detyrat e kursit, labororet, praktika profesionale, etj. Synohet dhe shpresohet që diplomantët të jenë të sukseshëm në një treg të gjërë punësh.

2. Njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përfundim të programit të studimit.

- Studenti mëson dhe zhvillon idetë e tij në teknikat më të rëndësishme të Pedagogjisë dhe kërkimit në fushën e edukimit fizik e shëndetësor.
- Disa lëndë bazë të pedagogjisë e didaktikës së fushës së edukimit fizik e shëndetësore e paisin studentin me njohuritë tipike të specialistit të këtyre fushave dhe me sensin e gjykimin shkencor për të analizuar sisteme dhe probleme komplekse të fushës së edukimit fizik e shëndetësor.
- Studenti aftësohet të formulojë dhe të zgjidh një sërë problemesh dhe modelesh praktike në fushën e pedagogjisë së edukimit fizik e shëndetësore me anën e njohurive teorike të fituara.
- Studenti aftësohet në modelimin dhe formulimin shkencor të problemeve pedagogjike nëpërmjet kërkimit në fushën e edukimit fizik e shëndetësor që modelohen për të optimizuar rezultatin.
- Studenti aftësohet në përdorimin e teknikave dhe aparaturave të avancuara si dhe në njohjen e përdorimin e tyre në mënyrë efektive duke garantuar efikasitet të lartë në arritjen e rezultateve.
- Studenti ekselent aftësohet dhe mund të vazhdojë studimet në programet e ciklit të tretë në Shkenca Sportive, Aktivitet Fizik dhe Shëndet ose fusha të afërta me të.
- Studenti aftësohet dhe mund të punojë në institucione të arsimit parauniversitarë e universitarë në fushën e edukimit fizik e shëndetësor dhe kërkimit në këto fusha.

Neni 4

Veprimtaritë formuese të programit të studimit

1. Në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes veprimtaritë formuese, që karakterizojnë programin e studimit, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor), studim individual (studim, punim relacionesh, detyrash apo projektesh), përgatitje për provime, përgatitje për detyrimet përmbyllëse, veprimtari të tjera, si praktika mësimore profesionale.
2. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:
 - a) Lëndë bazë të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
 - b) Lëndë karakterizuese, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
 - c) Lëndë ndërdisiplinore dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit lëndë me zgjedhje;
 - d) Lëndë plotësuese, të fokusuara në përfitim të aftësive informatike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikat profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta, të nënshkruara për këtë qëllim;
 - e) Detyrime përmbyllëse, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës.
3. Pësia që zë secila kategori e veprimtarive formuese në programin e studimit, e shprehur në përqindje të krediteve të alokuara, sipas llojit të programit, paraqiten në Tabelën 2.

Tabela 2: Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese në
Programin e Studimit të ciklit të dytë Master i Shkencave në
“Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor”

Kategoria dhe tipi i komponentit mësimor	Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese	Kredite (ECTS)	Totali i krediteve/ % përqindja
LËNDË BAZË (përgatitje metodologjike dhe kulturore e përgjithshme)	Psikologji Zhvillimi	5	9 ECTS 7.5 %
	Metodat e Kërkimit në Edukim	4	
(B) - LËNDË KARAKTERIZUESE (përgatitje për disiplinën shkencore)	Fiziologji e Aplikuar në Edukim Fizik dhe Shëndet	11	68 ECTS 56.6 %
	Shëndeti dhe Gjëndjet Kritike në moshat shkollore	5	
	Vlerësimi i të Nxënit		
	Metodologji e Mësimdhënies dhe të Nxënit	6	
	Metodikë e Lojrave Sportive	9	
	Metodikë e Atletikës		
	Metodikë e Sporteve Artistike	7	
	Koncepti i Mirëqënies Fizike dhe Edukim Shëndetësor	6	
	Kurrikula dhe Arsimi Gjithpërfshirës	6	
	Menaxhimi i Klasës		
	Trainingu	4	
C) - LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE (nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje)	Organizim i Edukimit Fizik dhe Sportit	2	19 ECTS 15.9 %
	Lëndë me Zgjedhje		
	Kineziologji		
	Kërkimi Shkencor i Aplikuar në Edukim Fizik dhe Shëndet	6	
(D)-LËNDË PLOTËSUESE (gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale)	Praktikë Profesionale Pedagogjike	9	12 ECTS
	Teknologji të Reja në Edukim Fizik dhe Shëndet	3	
(E) – DETYRIME PËRMBËLLËSE (teza e diplomës)	Punim Diplome	12	12 ECTS

Neni 6

Procedurat për pranimin e studentëve

1. Proçesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor" organizohet nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit dhe menaxhohet e monitorohet nga Rektorati i UST-së.
2. Proçesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, Master i Shkencave, zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar udhëzimet e MASR si dhe procedurën e përshkruar në Rregulloren e UST-së.
3. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar të paktën një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit dhe në këtë Rregullore.
4. Renditja e aplikantëve bëhet në bazë të mesatares së ponderuar të ciklit të parë të studimeve të diplomës bachelor dhe në përputhje me kriteret e tjera të vendosura nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, ku prioritet kanë aplikantët që zotërojnë një diplomë Bachelor në të njëjtën fushë në UST sipas një skeme vlerësimi të përcaktuar në rregulloret e sipërpërmendura.
5. Aplikantët të cilët vijnë nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, pranohen pa kredite debi në programin e studimit të ciklit të dytë.
6. Aplikantët të cilët vijnë nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, pranohen me kredite debi në programin e studimit të ciklit të dytë. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit përcakton disiplinat bazë dhe karakterizuese që duhet të japë kandidati, në funksion të njohurive pararendëse që duhet të ketë studenti, për të ndjekur programin përkatës të studimit. Numri total i krediteve shtesë për plotësimin e njohurive të tyre nuk duhet të jetë më i madh se 30 kredite. Detyrimet që i lindin aplikantit të shpallur fitues, kur vijnë nga fusha studimi të afërta i kominikohen aplikantit përpara regjistrimit të tij.
7. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në UST, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.
8. Fakulteti mund të njohë kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë "Master Profesional", me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit "Master i Shkencave", në përputhje me kornizën ligjore në fuqi duke respektuar procedurat dhe kërkesat e Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), të Rregullores së Përgjithshme të UST-së, të Rregullores së Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, të Rregullores së Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit dhe kësaj rregulloreje.

Neni 7

Transferimi i studimeve

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UST^{se} apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë publik ose private, vendase ose të huaja, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera, sipas procedurave të parashikuara në Rregulloren Përgjithshme të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit dhe Rregulloren e Transferimeve të UST^{se}. Programet e studimit dhe detyrimet e shlyera në institucione të tjera njihen dhe ekuivalentohen nga pikpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Njohja dhe ekuivalentimi i krediteve bëhet nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit ose Fakulteti të Shkencave të Lëvizjes pranë të cilit është paraqitur kërkesa për transferimin e studimeve.

Neni 8

Kushtet për transferimin e studimeve

1. Transferimet bëhen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përaturta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ofron mundësinë e transferimit të studimeve nga programe të sistemeve të mëparshme të studimeve universitare në UST, në programe të ciklit të dytë të studimeve. Transferimi i studimeve bëhet për studentët që kanë filluar studimet e ciklit të dytë në fusha të peraturta studimi:
 - Në fakultete të UST^{se}
 - Në Fakultete e Universitete Shqiptare publike apo private që kanë programe studimore të njëjta ose të ngjashme me fushat studimore të aktivitetit fizik dhe shëndet;
 - Në Fakultetet homologe të trevave Shqiptare ose dhe të Universiteteve të huaja.
2. Studenti mund të transferojë studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UST^{se}, apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:
 - a) ka fituar jo më pak se 30 kredite ilë programin përkatës të studimit, nga vjen;
 - b) plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit ose Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes;
 - c) në të kundërt, ai mund të fillojë studimet nga e para, duke ndjekur procedurat në hyrje në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.
3. Njohja e plotë e krediteve të fituara nga një student që transferohet, bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar kriteret e përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të UST^{se}, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, Rregulloren e Transferimeve si dhe në këtë rregullore.

Neni 9

Proçedurat për transferimin e studimeve

1. Proçedurat për transferimin e studimeve fillojnë në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik.
2. Kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, dokumentacionin e nevojshëm, të pëcaktuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Rregulloren e Përgjithshme të UST^{sc}, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, Rregulloren e Transferimeve si dhe në këtë rregullore.
3. Studenti që transferohet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë listën e notave, planin e plotë të programit dhe syllabuset përkatëse duhet t'i dorëzojë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin.
4. Sekretaria mësimore e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes ndjek të gjithë praktikën sipas udhëzimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin mbi proçedurat e aplikimit të kandidatëve.
5. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit ose Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes mund të vendosin kriteret specifike për pranimin e transferimit të studimeve, të cilat miratohen në Dekanat e Rektorat. Kriteret e pranimit shpallen publikisht me fillimin e proçesit të transferimeve në Fakultetin Shkencave të Lëvizjes.

Neni 10

Njohja e krediteve

1. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor", bëhet nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, sipas proçedurave dhe kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme të UST^{sc}, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, Rregulloren e Transferimeve si dhe në këtë rregullore.
2. Njohja e lëndëve/moduleve dhe krediteve bëhet duke pasur parasysh kreditet e lëndës, programin e lëndës dhe notën e marrë.
3. Lënda ose moduli ekuivalentohet kur:
 - a. ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm me lëndën/modulin e programit të studimit ku transferohet;
 - b. trajton tema të njëjta ose të ngjashme dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70% të lëndës/modulit që zhvillohet në programin e studimit në UST.
4. Në funksion të numrit të krediteve të njohura përcaktohet viti ku do të rregjistrohet studenti, si dhe numri i lëndëve dhe krediteve që duhet të plotësojë studenti në përputhje me programin e studimit ku është pranuar.

KREU II

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 11

Organizimi i studimeve

1. Studimet në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes, zhvillohen në Vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë. Viti akademik përfshin mësimdhënien, sezonin e provimeve, sezonin e mbrojtjes së diplomave. Mësimdhënia organizohet në dy semestra. Kohëzgjatja normale e një semestri zakonisht është 15 javë.
2. Organizimi i mësimdhënies i sezonit të provimeve dhe i sezonit të mbrojtjes së diplomave, përcaktohet në strukturën mësimore (kalenderin akademik), e cila miratohet dhe shpallet nga Rektori i UST^{se} në fillim të çdo viti akademik.
3. Programi i studimit të ciklit të dyte "Master i Shkencave " në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor", ofrohet në gjuhën shqipe.

Neni 12

Format specifike të mësimdhënies, provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studenti

1. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara, të pasqyruara në planet mësimore, në programet e lëndëve. Format kryesore të punës mësimore janë:
 - a. format e mësimit teorik e praktik, ku përfshihen: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, konsultimet, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj.;
 - b. format e kontrollit të dijeve, ku përfshihen: bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, mbrojtje e praktikave profesionale, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, mbrojtje e diplomave me provim të përgjithshëm, etj.
2. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit mund të propozojë edhe forma të tjera të punës mësimore, që janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit, veçanërisht ato të kontrollit të dijeve të fituara. Propozimet për format e reja bëhen para fillimit të vitit të ri akademik dhe pasqyrohen në planin mësimor të programit të studimit si dhe në programet e lëndëve (syllabus-e) së bashku me informacionet për ngarkesën mësimore, për orët në auditor/jashtë auditorit, për frekuentimin/ndjekjen e programit dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve.
3. Format e kontrollit të dijeve (si punë laboratorike, marrje/mbrojtje e detyrave, marrje/mbrojtje e projekteve, reflektohen në grafikët përkatës të detyrimeve, të cilët hartohen

- nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit. Kalendar i këtyre formave të kontrollit të dijeve shpalletjo më vonë se dy javë pas fillimit të semestrit.
4. Kontrolli i dijes së një lënde, e cila realizohet gjatë sezonit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet:
 - Provimit me shkrim, provimit me gojë, vlerësimi të projektit
 - Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt.
 5. Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet duke përdorur sistemin shqiptar të vlerësimi me nota, nga 4 tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal dhe 4 është ngelës. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nota minimale kaluese është 5 (pesë).
 6. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimi me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë.

Neni 13

Detyrimet specifike që lidhen me frekuentimin

1. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies së disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme e frekuentimit të tyre ndryshon në funksion të tipit të aktivitetit mësimor që realizohet, duke i klasifikuar fakultative, pjesërisht të detyrueshme dhe plotësisht të detyrueshme.
 - i) Frekuentimi i leksioneve si rregull nuk është i detyrueshëm por për lëndë e module të veçanta sipas përcaktimeve në syllabus-in e lëndës apo modulit të hartuar nga titullari frekuentimi i tyre mund të jetë i detyrueshëm deri në masën 50%, ndërsa seminarët dhe ushtrimet janë të detyrueshëm për tu shlyer në masën jo më pak se 75% të numrit të seancave të zhvilluara përpara hyrjes në provim të studentit .
 - ii) Frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 75%.
2. Për format e mësimi me frekuentim të detyruar, të pjesshëm, kur student i me ose pa arsye, nuk i shlyen ato deri para ditës së provimit shpallet i paklasifikuar dhe kalon për të shlyer detyrimet përpara të sezonit të provimeve pasardhës. Nëse student i nuk i shlyen detyrimet e lëndës/modulit edhe në sezonin e vjeshtës ai shpallet mbetës në atë lëndë. Ai është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimi në vitin pasardhës me të njëjtën detyrë frekuentimi.
3. Për formën e mësimi me frekuentim të detyrueshëm laborator, kur student i me ose pa arsye nuk merr pjesë në masën 75%, student e ndjek ato në vitn pasardhës. Departamenti përkatës i krijon studentit edhe një mundësi tjetër për të shlyer frekuentimin e detyruar para përfundimit të semestrit. Në rastet e përsëritjes së mungesave, student i ndjek ato në vitin pasardhës.

Neni 14

Kërkesat specifike për organizimin e praktikave profesionale

1. Praktika profesionale kryhen në përputhje me planin mësimor të miratuar në programin mësimor.
2. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 75% të orëve të praktikës profesionale, studenti detyrohet të respektojë rregullat e insitucioneve pritëse ku zhvillohet praktika.
3. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, pedagogu përgjegjës që e drejton atë, mban lidhje me institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer i cili vlerësohet nga pedagogu përgjegjës i grupit (pranë FSHL) së bashku me formularin e vlerësimit të institucionit pritës. Vlerësimi bëhet me notë mbi bazën e dukumentacionit të mësipërm nga pedagogu përgjegjës i grupit (pranë FSHL) i praktikës profesionale.
4. Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shlyen detyrimet për praktikën profesionale, Departamenti, mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në Departament) mund t'i japë të drejtën për rikryerjen e saj deri në fund të vitit akademik.

Neni 15

Plani mësimor

1. Tërësia e veprimtarive formuese shprehet në Planin Mësimor, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit. Plani mësimor përbën dukumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilin parashtrihen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë vijon:
 - a. Emërtimi i programit të studimit, viti akademik, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për të, fusha e studimit, kohëzgjatja normale e studimeve, forma e përmbylljes së studimeve, struktura mësimore e programit të studimit.
 - b. Tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara në semestra dhe të renditura sipas semestrave.
 - c. Kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brënda një disipline sipas veprimtarive formuese të saj (leksione/ ushtrime/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte, etj.), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor, mënyra e vlerësimit të lëndës.

Neni 16

Programi mësimor i lëndës

1. Programi mësimor i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Në programin mësimor të lëndës/modulit jepet në formë të përmbledhur:
 - a) të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor; emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës;
 - b) njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti, objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvehtësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda;
 - c) përmbajtja e lëndës, e ndarë në leksione dhe ushtrime/seminare, e detajuar në tematika që zhvillohen sipasjavëve mësimore;
 - d) përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave lëndore, temat e detyrave/projekteve të kursit;
 - e) forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse.
2. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës, ose grup titullarësh të lëndës dhe miratohet nga drejtuesi i Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes.
3. Titullari i lëndës dhe stafi mësimdhënës, në përfundim të procesit mësimor, japin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozojnë ndryshime në programin e lëndës.

Neni 17

1. Programi mësimor i lëndës. Programi mësimor i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor, Në programin mësimor të lëndës jepen:
 - a) të dhënat e përgjithshme për lëndën, Viti akademik, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor; emri i stafit mësimdhënës;
 - b) objektivat formuese të aplikuara, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti përvehtësimi i lëndës;
 - c) programi i lëndës;
 - d) mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë, ndihmëse dhe e rekomanduar.
2. Programet e lëndëve të programit të studimit të ciklit të dytë "Master i Shkencave " në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor" si pjesë e rregullores së programit të studimit, janë në fund të kësaj rregulloreje.

KREU III

DIPLOMIMI I STUDENTËVE

Neni 18

Kërkesat specifike për diplomimin e studentit

1. Në përfundim të programit të studimit, studentët diplomohen në "Master i Shkencave" në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor".
2. Studimet e ciklit të dytë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor" përmbillen me:
 - a) punim diplome ku kriter për studentët që fitojnë të drejtën do të jetë nota mesatare
 - b) dhe në përfundim të mbrojtjes lëshohet diplomë Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor".
3. Studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.
4. Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit përgatit tezën e provimit përfundimtar e cila bëhet në përputhje me kërkesat e Rregullores së Përgjithshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit, si dhe në këtë rregullore.
5. Studenti, para mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin.
6. Teza e diplomës së ciklit të dytë të studimeve është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti apo studimi me karakter përgjithësues në fushën e mesuesisë së edukimit fizik dhe shëndetit
7. Teza e diplomës përmban detyra dhe kërkesa, mënyra e shtrimit e cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore e projektuese, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për: modelimin, analizën dhe zgjidhjen e problemeve konkrete në fushën e mësimdhënies dhe të nxënit të edukimit fizik e shëndetësor.
8. Punimi i tezës së diplomës duhet të kryhet në një periudhë jo më pak se tre muaj nga përfundimi i detyrimeve (lëndët e planit mësimor).
9. Studenti ka të drejtë të propozojë temën e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e tij.
10. Studenti e zhvillon tezën e diplomës nën drejtimin e një udhëheqësi të miratuar.
11. Udhëheqësi i tezës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij.
12. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar, Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit.
13. Departamenti organizon tre kontrolle të ndërmjetëm, nëpërmjet të cilëve kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e saj. Përgjatë këtyre kontrolleve mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të tezës, të cilat nuk përmbysin thelbin e

punimit. Studenti dhe udhëheqësi mund t'i marrin parasysh rekomandimet e komisionit të kontrollit.

14. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës dhe ka kryer kontrollet në njësinë bazë.
15. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.
16. Drejtuesi i Departamentit plotëson fletën e kontrollit të tezës së diplomës, në të cilën regjistrohët kontrolli i kryer dhe vlerësimi me fialë për të.

Neni 19

Modaliteti i punimit të diplomës

1. Teza e diplomës duhet të ketë në strukturën e mëposhtme saj:

- qëllimi i studimit, abstrakti (shqip/anglisht)
- pjesa teorike,
- materiali dhe metoda
- rezultatet, diskutime, përfundime
- falënderime, literatura.

Pjesa teorike duhet të trajtojë çështje teorike në funksion të temës, që të ndihmojë sqarimet dhe të dhënat e përfuara gjatë punës eksperimentale. Në tërësi ky kapitull nuk duhet të jetë më shumë se rreth një e treta e gjithë punës, kurse rreth dy e treta duhet ti përkasë pjesës së punës individuale të kandidatit (materiali dhe metoda, rezultatet, diskutime, përfundime).

2. Punimi i diplomës e paraqitur në letër format A4, duhet të respektojë rregullat e mëposhtme të formatimit:

- shkrim Times Neë Roman (normal) e madhësi të gërmës 12,
- largësi rrjeti 1.5, duke lënë majtas 30 mm dhe në të tre anët e tjera 20 mm.

Neni 20

Diplomimi

1. Përgatitja e mbrojtjes së temave të diplomës bëhet në përputhje me kërkesat e Rregullores së Përgjithshme, Rregullores së Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregullores së Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit si dhe në këtë rregullore.
2. Komisioni i provimit të diplomes, përbëhet nga 3 (tre) — 5 (pesë) anëtarë.
3. Kur studentit vlerësohet me note kaluese, Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes e pajis studentin e sapo diplomuar me diplomën Master i Shkencave “Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor” të shoqëruar me suplementin e notave të saj.

4. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UST^{së}, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
5. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në provimin e diplomës, ai mund të hyjë në sesionet e ardhshme të provimeve të diplomimit, por pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi.
6. Gjatë periudhës kohore maksimale të përcaktuar kornizen ligjore nga koha e përfundimit të studimeve të plota, diplomanti ka të drejtë të mbrojë tezën e tij deri në tre herë.
7. Nëse në të tre rastet diplomanti është vlerësuar nga komisioni me notë jo-kaluese ose ai nuk paraqitet për të bërë mbrojtjen e punimit brënda afateve maksimale, atëherë studenti humbet të drejtën e diplomimit.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 21

Kjo Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor" e shtrin veprimtarinë e saj duke filluar nga Viti akademik 2022-2023.

Neni 22

Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor" është objekt rishikimi periodik. Rishikimi bëhet në fillim të vitit të ri akademik dhe synon përmirësimin dhe përditësimin e elementëve të ndryshëm të saj. Rishikimi bëhet mbi bazën e propozimeve që mund të vijnë nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, duke respektuar kuaridin ligjor në fuqi, në Statutin e UST^{së}, Rregulloren e Përgjithëshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Edukimit dhe Shëndetit si dhe në këtë rregullore. Propozimet shqyrtohen dhe miratohen në Departament, Fakultet, Rektorat e Senat të UST.

Neni 23

Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në "Mësuesi në Edukimin Fizik e Shëndetësor" është miratuar nga Departamenti i Edukimit dhe Shëndetit, Dekanati i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes dhe Organet e tjera vendim-marrëse të UST^{së}.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES
DEPARTAMENTI I SPORTEVE KOLEKTIVE

RREGULLORE MËSIMORE

E

PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË

“MASTER I SHKENCAVE”

“SHKENCA SPORTIVE”

Miratuar me Vendim Senati nr. 23 datë 16.02.2023

SHKURT 2023

K R E U I

INFORMACION MBI PROGRAMIN E STUDIMIT

Neni 1

Objekti, baza ligjore

1. Rregullorja e Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, *Master i Shkencave Në "Shkenca Sportive"*, përcakton kriteret dhe procedurat e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes për zhvillimin dhe menaxhimin e programit të studimit dhe të procesit mësimor në ciklin dytë.
2. Hartimi dhe miratimi i Rregullores Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, , mbështetet në Ligjin Nr. 80/2015, datë 05.10.2015, "Për arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Përgjithshme të UST, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, në Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive.

Neni 2

Të dhëna të përgjithshme

1. Të dhënat e përgjithshme për Programit të Studimit të Ciklit të Dytë, *Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"* paraqiten në Tabelën 1

Tabelën 1. Të dhëna të përgjithshme të Programit të Studimit

Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në "Në fushën e Shkencave Sportive"
Cikli i studimeve:	I dytë
Lloji i programit:	Master i Shkencave
Totali i Krediteve (ECTS):	120 ECTS
Kohezgjatja normale në vite	2 vite akademike
Forma e studimit:	Studime me kohë të plotë
Gjuha e studimit:	Shqip
Departamenti përgjegjës	Departamenti i Sporteve Kolektive
Fakulteti përgjegjës	Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes
Struktura të tjera bashkëpunuese brenda institucionit apo në institucione të tjera të arsimit të lartë	Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit Fakulteti i Shkencave të Reabilitimit
IKSHS, Institucione të huaja të arsimit të lartë	Subjekte të tjera publike apo private

Neni 3

Objektivat formuese dhe karakteristikat e programit të studimit

1. Objektivat formuese të programit të studimit:

Shkenca sportive janë një profesion që mbështetet në formimin akademik dhe në një spektër të gjërë njohurish të avancuara të disiplinave sportive.

Kursi i studimeve i ciklit të dytë *Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"*, i cili zgjat 2 (dy) vite akademike, ka si objektiv plotësimin dhe thellimin e formimit të të diplomuarve Bachelor me shprehje bazë shkencore dhe të avancuara në fushën e shkencave sportive dhe asaj të shëndetit.

Programi operon dhe mbështete në katër kolona bazë.

I) Njohuri bazë teorike në fushat e shkencave sportive dhe shëndetit të cilat lehtësojnë komunikimin midis tyre.

II) Nje grupim kursesh të fushës së shkencave sportive

III) Nje grupim kursesh të shëndetit

IV) Nje grup të gjërë kursesh të lidhuara me fushën e shkencave sportive dhe shëndetit të lidhura me zbatime të shumta që kanë nevojë për njohuritë bazë teorike të këtij programi dhe që mbështeten nga kurset e grupimeve II) dhe III) më sipër.

Viti i parë konsiston në dhënien dhe konsolidimin e njohurive bazë I) dhe vazdon me kurset e 3 grupimeve të tjera sipas një rradhe që respekton përmbajtjen dhe varësinë e tyre nga njëri tjetri. Edukimi vazhdon me zbatimin njohurive të fituara në praktikën profesionale dhe punimin e tezës së diplomimit. Si rregull teza e diplomimit është e lidhur me kurset e grupimeve II) dhe III) dhe në raste të vecanta me ato të grupimit IV), kur punimi ka karakter të mirëfilltë zbatues dhe është i lidhur me një zbatim specifik e konkret të lidhur me fushën e shkencave sportive dhe shëndetit.

Programi synon të aftësojë studentët me teknikat moderne të sportit dhe mjekësisë sportive, dhe zgjidhjen e problemeve në fushat e shkencave sportive dhe shëndetit, të cilat nuk mund të bëhen me anën e programeve standarde. Synohet që studentët të zhvillojnë idetë dhe aftësitë e tyre në përballje të drejtpërdrejtë me zgjidhjen e problemeve të fushës së shkencave sportive dhe të shëndetit të jetës reale. Një peshë të ndieshme në program zë puna e pavarur e studenteve, projektet, detyrat e kursit, laboratorët, praktikat.

Synohet dhe shpresohet që diplomantët të jenë të sukseshëm në një treg të gjërë punësh.

2. Njohuritë dhe aftësitë e studentëve në përfundim të programit të studimit

- 1) Studenti mëson dhe zhvillon idetë e tij në teknikat më të rëndësishme të fushës së shkencave sportive.
- 2) Disa lëndë bazë të programit të studimit e paisin studentin me njohurite tipike të specialistit të fushës së shkencave sportive dhe me sensin e gjykimin shkencor për të analizuar sisteme dhe probleme komplekse të fushës.
- 3) Studenti aftësohet të formulojë dhe të zgjidhë një sërë problemesh dhe modelesh praktike në fushën e shkencave sportive dhe shëndetit me anën e njohurive teorike të fituara.
- 4) Studenti aftësohet në modelimin dhe formulimin shkencor të problemeve në fushën e shkencave sportive dhe shëndetit që modelohen për të optimizuar rezultatin.
- 5) Studenti aftësohet në përdorimin e teknikave të avancuara si dhe në njohjen e përdorimit të tyre në mënyrë efektive duke garantuar efikasitet të lartë në arritjen e rezultateve.
- 6) Studenti ekselent aftësohet dhe mund të vazhdojë studimet në programet e ciklit të tretë.
- 7) Studenti aftësohet dhe mund të punojë si në sektorin publik dhe privat.

Neni 4

Veprimtaritë formuese të programit të studimit

1. Në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes veprimtaritë formuese, që karakterizojnë programin e studimit, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: mësim në auditor (leksione, seminare, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor), studim individual (studim, punim relacionesh detyrash apo projektesh), përgatitje për provime, përgatitje e tezës së diplomës, veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë institucioneve publike ose private.

2. Veprimtaritë formuese grupohen në kategoritë e mëposhtme:

- a) *Lëndë bazë* të programit të studimit, që përcaktojnë formimin e përgjithshëm, përgatitjen metodologjike dhe kulturën e përgjithshme;
- b) *Lëndë karakterizuese*, që lidhen me veçoritë e programit të studimit dhe japin një formim specifik, sipas karakteristikave të tij;
- c) *Lëndë ndërdisiplinore* dhe/ose integruese në një ose më shumë grupe disiplinash, të ngjashme dhe/ose integruese me disiplinat karakterizuese, profile të programit dhe grup- lëndë me zgjedhje;
- d) *Lëndë plotësuese*, të fokusuar në përfundimin e, aftësive informatike, aftësive komunikuese e prezantuese, aftësive që lehtësojnë hyrjen në tregun e punës dhe në praktikën profesionale të zhvilluara pranë subjekteve publike e private, sipas marrëveshjeve të përbashkëta,

të nënshkruara për këtë qëllim;

e) *Detyrime përmbyllëse*, që lidhen me përgatitjen e tezës së diplomës.

3. Pesha që zë secila kategori e veprimtarive formuese në programin e studimit, e shprehur në përqindje të krediteve të alokuara, sipas llojit të programit, paraqitete në Tabelën 2.

Tabela 2 Lista e disiplinave mësimore dhe veprimtaritë e tjera formuese në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në "Shkenca Sportive".

<i>Kategoria dhe tipi i komponentit mësimor</i>	<i>Fushat disiplinore apo veprimtari të tjera formuese</i>	<i>Kredite (ECTS)</i>	<i>Totali i krediteve/ Përqindja</i>
(A) - LËNDË BAZË - përgatitje metodologjike dhe kulturë epërgjithshme	Mjek. Parandaluese, Të ushqyerit në Sp.	8	12 ECTS / 10 %
	Aspekte Socio-Humane të Sportit	4	
	Kineziologji Sportive	11	
	Kërkimi Shkencor	10	
(B) LËNDË KARAKTERIZUESE – përgatitje për disiplinën shkencore	Aktiviteti Fizik dhe Shëndeti	7	64 ECTS / 53 %
	Fiziologji Sportive, Vlerësim Funksio.	13	
	Trainimi në Sport	8	
	Njohuri të Avancu. Psiko-Sociale në Sp. Organizimi dhe Menaxhimi në Sport	9	
(C) LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje	Njohuri të Avancuara Biomjek. në Sp	9	20 ECTS / 17 %
	Mjekësi Sportive	11	
(D) LËNDË PLOTËSUESE – Gjuhë e huaj, njohuri informatike, praktika	Teknologjia dhe Vlerësimi në Sport	5	12 ECTS / 10%
	Aplikime Bashkëkohore në Sport/ Lëndë me Zgjedhje	7	
(E) DETYRIME PËRMBYLLËSE - Teza e diplomës	Tezë Diplome	12	12 ECTS / 10%

K R E U II

PRANIMI I STUDENTËVE

Neni 5

Kriteret dhe procedurat specifike për pranimin e studentëve

1. Kanë të drejtë të aplikojnë për programin e studimit të ciklit të dytë *Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"*, kandidatët që:

a) Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë, në një program të ciklit të parë në fushën përkatëse të studimit ose në fusha të tjera të përafërta, i cili rezulton i akredituar në momentin e regjistrimit të studentit.

b) Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë, të akredituar. Në çdo rast pranimi kandidati duhet të ketë kryer njësimin e diplomës pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin.

2. Në studimet e ciklit të dytë *Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"*, pranohen:

a) Pa njohuri plotësuese, studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:

- Diplomuar në një nga programet Bachelor të ofruara nga UST.
- "Bachelor" në "Shkencat e Lëvizjes", "Fushat e Veprimtarisë Fizike të Shëndetit

dhe të Rekreacionit", në universitete të tjera.

- Diplomë e Niveli të Parë në fusha të ngjashme;
- Nga fusha të njëjta, të përafërta ose të ndërlidhura me Shkencat Sportive, ku përfshihen:

➤ *Diplomat e ciklit të parë të integruara*

➤ *Master në Shkencat Mjekësore*

b) Me plotësim të njohurive,

Studentët që zotërojnë Diplomë Universitare të ciklit të parë:

- "*Bachelor*" ose *Diplomë e Niveli të Parë* nga fusha të tjera dhe që kanë interesa në studim të Shkencave Sportive pranohen në plotësim të njohurive në disiplinat e Mjekësisë Sportive (Fiziologji, Anatomí, Biologji dhe Biomekanikë).

3. Kriter pranimi në një program studimi të ciklit të dytë "Master i shkencave" është njohja nga kandidati e një prej pesë gjuhëve të huaja të Bashkimit Evropian: anglisht, frëngjisht, gjermanisht, italisht, spanjisht në përputhje me udhëzimin e ministrisë përkatëse për arsimin, ku përcaktohet dhe tipi i çertifikatës së fituar. Nëse individi ka fituar një diplomë të një programi studimi të kryer në një nga këto gjuhë, diploma e fituar shërben si dëshmi për plotësimin e këtij kriteri.

4. Në varësi të kërkesave dhe kuotave të përcaktuara nga institucionet përgjegjëse, përparësi do të kenë studentët që kanë përfunduar drejtime studimi ekuivalente, brenda dhe jashtë shtetit, si dhe notë mesatare më të lartë. Ky kriter do të jetë i rivlerësueshëm çdo vit akademik, në varësi të studentëve konkurrues.

Neni 6

Procedurat për pranimin e studentëve

1. Procesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, *Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"* organizohet nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes, Departamenti i Sporteve Kolektive dhe menaxhohet dhe monitorohet nga rektorati i UST-së.
2. Procesi i pranimit dhe regjistrimit të kandidatëve në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë, *Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"* zhvillohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar udhëzimet e ministrisë përgjegjëse të arsimit, si dhe procedurën e përshkruar në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Përgjithshme të UST, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, në Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe këtë rregullore.
3. Pranimi në programet e ciklit të dytë të studimeve është i mundur për kandidatët që kanë përfunduar të paktën një program studimi të ciklit të parë dhe plotësojnë kriteret e pranimit të të përcaktuar në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Përgjithshme të UST, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, në Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe këto rregullore.
4. Renditja e aplikantëve bëhet në bazë të mesatares së ponderuar të ciklit të parë të studimeve të diplomës bachelor dhe në përputhje me kriteret e tjera të vendosura nga Departamenti i Sporteve Kolektive, ku prioritet kanë aplikantët që zotërojnë një diplomë Bachelor në të njëjtën fushë në UST.

5. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të njëjta ose të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është jo më pak se 70%, pranohen pa kredite debi në programin e studimit të ciklit të dytë.

6. Aplikantët, të cilët vijnë nga fusha të përafërta, ku përputhshmëria e programeve përkatëse të studimit të ciklit të parë të shprehur në kredite është më pak se 70%, pranohen me kredite debi në programin e studimit të ciklit të dytë. Departamenti i Sporteve Kolektive përcakton disiplinat bazë dhe karakterizuese që duhet të japë kandidati, në funksion të njohurive pararendëse që duhet të ketë studenti, për të ndjekur programin përkatës të studimit. Numri total i krediteve shtesë për plotësimin e njohurive të tyre nuk duhet të jetë më i madh se 30 kredite. Detyrimet që i lindin aplikantit të shpallur fitues, kur vijnë nga fusha studimi të afërta dhe i komunikohen aplikantit përpara regjistrimit të tij.

7. Kandidati nuk mund të ndjekë njëkohësisht dy programe studimi në UST, me përjashtim të studentëve të shkëlqyer.

8. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes mund të njohë kredite të përfituara në programet e studimit të ciklit të dytë “Master profesional”, me qëllim transferimin e tyre në programet e studimit “Master i shkencave”, në përputhje me kornizën ligjore në fuqi duke respektuar procedurat dhe kërkesat e Statutit të Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), të Rregullores së Pergjithëshme të UST-se, të Rregullores së Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, të Rregullores së Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe kesaj rregulloreje.

Neni 7 Transferimi i studimeve

Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UST-se apo institucioneve të ndryshme të arsimit të lartë publike ose private, vendase ose të huaja, dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera, sipas procedurave të parashikuara në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Pergjithëshme të UST, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, në Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe këto rregullore. Programet e studimit dhe detyrimet e shlyera në institucione të tjera njihen dhe ekuivalentohen nga pikpamja e së drejtës për të vazhduar arsimimin, në një program studimi të njëjtë ose të ngjashëm. Njohja dhe ekuivalentimi i krediteve bëhet nga Departamenti i Sporteve Kolektive ose Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes pranë të cilit është paraqitur kërkesa për transferimin e studimeve.

Neni 8

Kushtet për transferimin e studimeve

1. Transferimet bëhen brenda të njëjtit cikël studimi dhe në fusha studimi të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ofron mundësinë e transferimit të studimeve nga programe të sistemeve të mëparshme të studimeve universitare në UST në programe të ciklit të dytë të studimeve. Transferimi i studimeve bëhet për studentët që kanë filluar studimet e ciklit të dytë Master i shkencave në fusha të afërta studimi:

- *fakultete të UST-së;*
- *fakultetet e shkencave të lëvizjes, apo të veprimtarisë fizike dhe rekreacionit të universiteteve shqiptare;*
- *fakultetet e shkencave të lëvizjes, apo të veprimtarisë fizike dhe rekreacionit të universiteteve të huaja.*

2. Studenti mund të transferoj studimet, midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UST apo nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, nëse:

- a) ka fituar jo më pak se 30 kredite në programin përkatës të studimit, nga vjen;
- b) plotëson kriteret specifike për transferimin e studimeve të përcaktuara nga Departamenti i Sporteve Kolektive ose Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes;
- c) në të kundërt, ai mund të fillojë studimet nga e para, duke ndjekur procedurat në hyrje në përputhje me kornizën ligjore në fuqi

3. Njohja e plotë të krediteve të fituara nga një student që transferohet, bëhet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, duke respektuar kriteret e përcaktuara në Statutin e Universitetit të Sporteve të Tiranës (UST), në Rregulloren e Pergjithshme të UST, në Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, në Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe këto rregullore.

Neni 9

Procedurat për transferimin e studimeve

1. Procedurat për transferimin e studimeve fillojnë në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe pranohen në fillim të çdo viti akademik.

2. Kandidati paraqet pranë sekretarisë mësimore të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, dokumentacionin e nevojshëm, të përcaktuar në udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin, në Rregulloren e Pergjithshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, Rregulloren e Transferimeve, si dhe në këtë rregullore.

3. Studenti që transferohet nga një institucion i huaj i arsimit të lartë listën e notave, planin e plotë të programit dhe syllabuset përkatëse duhet ti dorëzojë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të njësuar me origjinalin.
4. Sekretaria mësimore e Fakultetit e Mjekësisë Sportive ndjek të gjithë praktikën sipas udhëzimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin mbi procedurat e aplikimit të kandidatëve.
5. Departamenti i Sporteve Kolektive ose Fakulteti i Shkencave Mjekësore mund të vendosin kritere specifike për pranimin e transferimit të studimeve, të cilat miratohen në Dekanat. Kriteret e pranimit shpallen publikisht me fillimin e procesit të transferimeve në Fakultetin Shkencave Mjekësore.

Neni 10 **Njohja e krediteve**

1. Njohja e krediteve të marra nga një student, me qëllim vazhdimin e studimeve të ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Sportive”, në Fakultetin e Shkencave Sportive, bëhet nga Departamenti i Sporteve Kolektive, sipas procedurave dhe kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Pegitheshme, Rregulloren e Fakultetit e Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, Rregulloren e Transferimeve, si dhe në këtë rregullore.
2. Njohja e lëndëve/moduleve dhe krediteve bëhet duke patur parasysh kreditet e lëndës, programin e lëndës dhe notën e marrë.
3. Lënda ose moduli ekuivalentohet kur:
 - a) ka emërtim të njëjtë ose të ngjashëm me lëndën/modulin e programit të studimit ku transferohet;
 - b) trajton tema të njëjta ose të ngjashme dhe ka përputhje të ngarkesës në auditor në masën mbi 70% të lëndës/modulit që zhvillohet në programin e studimit në UST-se.
4. Në funksion të numrit të krediteve të njohura përcaktohet viti ku do të regjistrohet student, si dhe numri i lëndëve dhe krediteve që duhet të plotësojë studentin në përputhje me programin e studimit ku është pranuar.

Neni 11

Njohja e krediteve të fituara në programet Master Profesional

1. Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes mund të njohë si kredite të realizuara për programin e studimit të ciklit Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” kreditet e fituara në programet Master Profesional, kur ato janë në përputhje me objektivat specifike të këtij programi studimit.
2. Njohja e krediteve realizohet nga komisionin adhoc *i njohjes dhe ekuivalentimit*, me të paktën 3 anëtarë, i cili pas verifikimit të sasisë së krediteve dhe orëve të zhvilluara, për programet lëndore me të njëjtin emërtim ose të përafërta, të zhvilluar në programin e ciklit të

dytë "Master Profesional", merr vendimin mbi sasinë e krediteve të njohura, të cilin ia përcjellë për miratim dekanit të Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes.

3. Fakulteti Shkencave të Lëvizjes nuk njih si kredite të realizuara për një program studimi të ciklit të dytë, kredite të fituara në çfarëdo program studimi të ciklit të parë.

Neni 12

Ndjekja e një programi të dytë studimi

1. Studentët që kanë kryer një program studimi të ciklit të dytë, kanë të drejtë të ndjekin një program të dytë studimi, në të njëjtin cikël studimi, në përputhje me kriteret e pranimit të përcaktuara në Rregulloren e Përgjithshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe në këtë rregullore.
2. Procedurat e aplikimit për program të dytë studimi bëhen në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi. Studentit i njihen kriteret e fituara në përputhje me kërkesat e Rregullores së Zhvillimit Kurrikuar dhe Mësimdhënies në UTP, si dhe të kësaj rregulloreje studimi.

K R E U III

ORGANIZIMI I STUDIMEVE

Neni 13

Organizimi i studimeve

1. Studimet në Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes zhvillohen në vite akademike. Data zyrtare e fillimit të vitit akademik shpallet nga ministri përgjegjës për arsimin e lartë. Viti akademik përfshin mësimdhënien, sesionin e provimeve, sesionin e mbrojtjes së diplomave. Mësimdhënia organizohet në dy semestra. Kohëzgjatja normale e një semestri zakonisht është 15 javë .
2. Organizimi i mësimdhënies, i sesionit të provimeve dhe i sesionit të mbrojtjes së diplomave, shprehet në strukturën mësimore (kalendarin akademik), e cila miratohet dhe shpallet nga Rektori i UST-se në fillim të cdo viti akademik.
3. Programi i studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” ofrohet në gjuhën shqipe.

Neni 14

Format specifike të mësimdhënies, provimeve dhe verifikimeve të tjera të dijeve të fituara nga studenti

1. Puna mësimore me studentët përfshin një larmi formash të mësimit dhe të kontrollit të dijeve. Këto forma harmonizohen midis tyre përmes raporteve të caktuara, të pasqyruara në planet mësimore, në programet e lëndëve. Format kryesore të punës mësimore janë:
 - a) format e mësimit teorik e praktik, ku përfshihen: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, konsultimet, detyrat e kursit, projektet e kursit, projekt – diplomat, etj.;
 - b) format e kontrollit të dijeve, ku përfshihen: bashkëbisedimet, mbrojtje e punëve laboratorike, mbrojtje e detyrave dhe/ose projekteve të kursit, provime të ndërmjetme, provimet e lëndës, mbrojtje e temave e diplomave, etj.
2. Departamenti i Sporteve Kolektive mund të propozojë edhe forma të tjera të punës mësimore, që janë të përshtatshme për realizimin e programit të studimit, veçanërisht ato të kontrollit të dijeve të fituara. Propozimet për format e reja bëhen para fillimit të viti të ri akademik dhe pasqyrohen në planin mësimor të programit të studimit si dhe në programet e lëndëve (*syllabus*-e) së bashku me informacionet për ngarkesën mësimore, për orët në auditor/jashtë auditorit, për frekuentimin/ndjekjen e programit dhe për mënyrën e vlerësimit të dijeve.
3. Format e kontrollit të dijeve (si punë laboratorike, marrje/mbrojtje e detyrave, marrje/mbrojtje e projekteve, reflektohen në grafikët përkatës të detyrimeve, të cilët hartohen nga

Departamenti i Sporteve Kolektive. Kalendar i këtyre formave të kontrollit të dijeve shpallet jo më vonë se dy javë pas fillimit të semestrit.

4. Kontrolli i dijës së një lënde, e cila realizohet gjatë sesionit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet:

- Provimit me shkrim;
- Provimit me gojë;
- Vlerësimin të projektit;
- Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt.

5. Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet duke përdorur sistemin shqiptar të vlerësimin me 10-të nota, nga 4 tek 10-ta, ku 10-ta është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nota minimale kaluese është 5 (pesë).

6. Në format e kontrollit me shkrim përdoret sistemi i vlerësimin me pikë, rezultati i të cilit, detyrimisht, kthehet në notë.

Neni 15

Detyrimet specifike që lidhen me frekuentimin

1. Studenti duhet të ndjekë të gjitha format e mësimdhënies së disiplinave të përcaktuara në planin mësimor. Masa e detyrueshme e frekuentimit të tyre ndryshon në funksion të tipit të aktivitetit mësimor që realizohet, duke i klasifikuar facultative, pjesërisht të detyrueshme dhe plotësisht të detyrueshme.

i. Frekuentimi i leksioneve si rregull nuk është i detyrueshëm por për lende e module të vecanta sipas përcaktimeve në syllabus-in e lendes apo modulit të hartuar nga titullari frekuentimi I tyre mund të jetë i detyrueshëm deri në masën 50%, ndërsa seminarët dhe ushtrimet janë të detyrueshëm për të shlyer në masën jo më pak se 75% të numrit të seancave të zhvilluara përpara hyrjes në provim të studentit.

ii. Frekuentimi i punëve laboratorike, punëve praktike dhe praktikave mësimore është plotësisht i detyrueshëm në masën 100%.

2. Për format e mësimin me frekuentim të detyruar, të pjesshëm, kur studentin me ose pa arsye, nuk i shlyen ato deri para ditës së provimit shpallet i paklasifikuar dhe kalon për të shlyer detyrimet përpara në sezonin të provimeve pasardhës. Nëse studentin nuk i shlyen detyrimet e lendes edhe në sezonin e vjeshtës ai shpallet mbetës në ato lende. Ai është i detyruar të ndjekë përsëri format e mësimin në vitin pasardhës me të njëjtën detyrë frekuentimi.

3. Për formën e mësimin me frekuentim të detyrueshëm laborator, kur studentin me ose pa arsye nuk merr pjesë qoftë edhe në një seancë mësimi, departamenti përkatës i krijon studentit edhe një mundësi tjetër për të shlyer frekuentimin e detyruar para përfundimit të semestrit. Në rastet e përsëritjes së mungesave, studentin i ndjek ato në vitin pasardhës.

Neni 16

Kërkesat specifike për organizimin e praktikave profesionale

1. Praktika profesionale kryhet semestrin e fundit në një periudhë prej----- javësh. Studentët kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës profesionale. Studenti detyrohet të respektojë rregullat e kompanisë/institucionit pritës.
2. Institucionet publike dhe private ku mund të kryhet praktika profesionale janë:
 -
 -
 -
 -
 -
3. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, pedagogu përgjegjës që e drejton atë, mban lidhje me kompaninë/institucionin ku ajo kryhet. Në përfundim të praktikës profesionale, studenti përgatit një relacion për punën e kryer i cili vlerësohet nga komisioni i ngritur në departament se bashku me formularin e vleresimit të institucionit pritës.. Vlerësimi bëhet me notë mbi bazën e dokumentacionit të mesipër nga komisioni i ngritur nga Departamenti i Sporteve Kolektive për mbrojtjen e praktikës. Komisioni formohet zakonisht nga pedagogët përgjegjës që drejtojnë praktikën.
4. Në rastet kur studenti për arsye objektive nuk shlyen detyrimet për praktikën mësimore, Departamenti, mbështetur në kërkesën e studentit (depozituar në Departament) mund t'i japë të drejtën për rikryerjen e praktikës mësimore deri në fund të vitit akademik.

Neni 17

Plani mësimor

1. Tërësia e veprimtarive formuese shprehet në *Planin Mësimor*, i cili është dokumenti themelor i programit të studimit. Plani mësimor përbën dokumentacionin kryesor me karakter të gjerë informativ, në të cilin parashtrihen në mënyrë të përmbledhur sa mëposhtë vijon:
 - a) Emërtimi i programit të studimit, viti akademik, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për të, fusha e studimit, kohëzgjatja normale e studimeve, forma e përmbylljes së studimeve, struktura mësimore e programit të studimit
 - b) Tërësia e veprimtarive formuese (disiplinave) që përbëjnë programin e studimit, të grupuara në semestra dhe të renditura sipas semestrave.
 - c) Kreditet për çdo veprimtari formuese, shpërndarjen e krediteve brenda një discipline sipas veprimtarive formuese të saj (leksione/ ushtrime/ seminare/ laboratorë/ detyra/ projekte,

etj.), ngarkesa në auditor, ngarkesa javore në auditor, mënyra e vlerësimit të lëndës.

2. Hartimi/rishikimi i Planit mësimor bëhet sipas procedurës së përshkruar në Statutin e UST-se, Rregulloren e Përgjithshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe në këtë rregullore.

Neni 18

Programi mësimor i lëndës

1. Programi mësimor i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Në programin mësimor të lëndës jepet në formë të përmbledhur:

a) të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, njësia bazë përgjegjëse për zhvillimin e lëndës, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor; emri i titullarit të lëndës dhe i stafit mësimdhënës;

b) njohuritë paraprake që duhet të ketë fituar studenti, objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvehtësimi i lëndës, konceptet dhe termat bazë mbi të cilat ndërtohet lënda;

c) përmbajtja e lëndës, e ndarë në leksione dhe ushtrime/seminare, e detajuar në tematika që zhvillohen sipas javëve mësimore;

d) përmbajtja e punëve laboratorike, praktikave lëndore, temat e detyrave/projekteve të kursit;

e) forma e kontrollit që do të përdoret, parakushtet e hyrjes në provim, mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë dhe ajo ndihmëse.

2. Programi mësimor i lëndës hartohet nga titullari i lëndës, ose grup lektorësh të lëndës, rishikohet nga Kordinatori i Programit të Studimit (KPS) në Departamenti dhe miratohet nga drejtuesi i Departamentit të Sporteve Kolektive dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave Mjekësore.

3. Titullari i lëndës dhe stafi mësimdhënës, në përfundim të procesit mësimor, japin mendime në lidhje me zhvillimin e lëndës, si dhe propozojnë ndryshime në programin e lëndës.

Neni 19

Programi mësimor i shkurtuar i lëndës

1. Programi mësimor i shkurtuar i lëndës hartohet për çdo disiplinë që përmban plani mësimor. Në programin mësimor të shkurtuar të lëndës jepet në formë të përmbledhur:

a) të dhënat e përgjithshme për lëndën, viti akademik, struktura e lëndës sipas ndarjeve të bëra në planin mësimor; emri i stafit mësimdhënës;

- b) objektivat formuese të lëndës, njohuritë dhe aftësitë që përfton studenti nga përvehtësimi i lëndës;
 - c) programi i përmbledhur i lëndës;
 - d) mënyra e vlerësimit përfundimtar, literatura bazë.
2. Programi mësimor i shkurtuar i lëndës hartohet nga titullari i lëndës, ose grup lektorësh të lëndës, rishikohet nga Koordinator i Programit të Studimit në Departament dhe miratohet nga drejtuesi i Departamentit të Sporteve Kolektive dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes.
3. Programet e shkruara të lëndëve të Programit të studimit të Ciklit Të dytë Master i Shkencave “Në Fushën e Shkencave Sportive” si pjesë e rregullores së Programit të Studimit, janë në fund të kësaj rregulloreje.

K R E U I V

DIPLOMIMI I STUDENTËVE

Neni 20

Kërkesat specifike për diplomimin e studentit

1. Në përfundim të kursit të plotë të programit të studimit , studentet diplomohen në Master i Shkencave në “Shkenca Sportive”.
2. Studimet e ciklit të dytë Master i shkencave në “Shkenca Sportive” përmbyllen me punim diplome dhe në përfundim të tyre lëshohet diplomë Master i shkencave në “Shkenca Sportive”.
3. Studenti nuk mund të mbrojë tezën e diplomës pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planet mësimore të programit përkatës të studimit.
4. Studenti, para mbrojtjes së punimit të diplomës, duhet të ketë shlyer të gjitha detyrimet financiare dhe materiale që mund të ketë me universitetin.
5. Teza e diplomës së ciklit të dytë të studimeve është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një projekti apo studimi me karakter përgjithësues në fushën e shkencave sportive dhe të shëndetit.
6. Teza e diplomës përmban detyra dhe kërkesa, mënyra e shtrimit e të cilave i jep mundësi studentit, që nëpërmjet njohurive të fituara gjatë periudhës së shkollimit dhe punës konkrete studimore e projektuese, të tregojë aftësitë e tij profesionale dhe kompetencën për: modelimin, analizën dhe zgjidhjen e problemeve konkrete në fushën e shkencave sportive dhe të shëndetit.
7. Punimi i tezës së diplomës duhet të kryhet në një periudhë jo më pak se tre muaj nga përfundimi i detyrimeve (lëndët, modulet e planit mësimor).
8. Studenti ka të drejtë të propozojë temën e diplomës që kërkon të zhvillojë, dhe udhëheqësin e tij.
9. Studenti e zhvillon tezën e diplomës nën drejtimin e një udhëheqësi të miratuar.
10. Udhëheqësi i tezës së diplomës përgatit programin e punës së studentit, duke vendosur edhe afatet e përafërta të realizimit të tij.
11. Udhëheqësi përcakton grafikun e konsultimeve të programuara me studentin, përgjatë të cilave konsultohet dhe kontrollohet puna e bërë sipas programit të miratuar. Grafiku i konsultimeve është i detyrueshëm të zbatohet nga studentit.

12. Departamenti i Sporteve Kolektive organizon tre kontrolle të ndërmjetëm, nëpërmjet të cilëve kontrollohet volumi i punës së kryer dhe cilësia e saj. Përgjatë këtyre kontrolleve mund të rekomandohen edhe ndryshime apo përmirësime të programit të tezës, të cilat nuk përmbysin thelbin e punimit. Studenti dhe udhëheqësi mund t'i marrin parasysh rekomandimet e komisionit të kontrollit.

13. Studenti fiton të drejtën për të mbrojtur diplomën, kur ai ka përfunduar të gjithë programin e punës dhe ka kryer kontrollet në njësinë bazë.

14. Para mbrojtjes së tezës së diplomës, udhëheqësi rishikon dhe miraton punimin e kryer nga studentit dhe lejon mbrojtjen e punimit duke firmosur tezën e diplomës.

15. Drejtuesi i Departamentit të Sporteve Kolektive plotëson fletën e kontrollit të tezës së diplomës, në të cilën regjistrohet kontrolli i kryer dhe vlerësimi me fjalë për të.

Neni 21

Modaliteti i punimit të diplomës

1. Teza e diplomës duhet të ketë në strukturën e mëposhtme saj:

- qëllimi i studimit, abstrakti (shqip/anglisht)
- pjesa teorike,
- materiali dhe metoda,
- rezultatet, diskutime, përfundime,
- falënderime,
- literatura.

Pjesa teorike duhet të trajtojë çështje teorike në funksion të temës, që të ndihmojë sqarimet dhe të dhënat e përfuara gjatë punës eksperimentale. Në tërësi ky kapitull nuk duhet të jetë më shumë se rreth një e treta e gjithë punës, kurse rreth dy e treta duhet ti përkasë pjesës së punës individuale të kandidatit (materiali dhe metoda, rezultatet, diskutime, përfundime).

2. Punimi i diplomës e paraqitur në letër format A4, duhet të respektojë rregullat e mëposhtme të formatimit:

- shkrim Times New Roman (normal) e madhësi të gërmës 12,
- largësi rrjeti 1.5, duke lënë majtas 30 mm dhe në të tre anët e tjera 20 mm.

Neni 22

Diplomimi

1. Fakulteti i Mjekësisë Sportive organizon sesionet për mbrojtjen e diplomave:, në përputhje me strukturën akademike (Kalendarin akademik) duke respektuar procedurën e përshkruar në Statutin e UST-se, Rregulloren e Pegitheshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe në këtë rregullore.
2. Përgatitja dhe paraqitja e tezës së diplomës bëhet në përputhje me kërkesat e Statutit të UST-se, Rregulloren e Pergjithshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe në këtë rregullore.
3. Mbrojtja e diplomës është publike dhe realizohet para komisionit të diplomimit, i përbërë nga 3 (tre) – 5(pesë) anëtarë.
4. Në përfundim të çdo seance të mbrojtjes së tezave të diplomave, kryetari i komisionit, në prani të anëtarëve, i komunikon çdo diplomanti notën, me të cilën është vlerësuar punimi i tij.
5. Nota është mesatarizim i vlerësimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit.
6. Kur studenti vlerësohet me notë kaluese, Fakulteti i Shkencave Sportive e pajis studentin e sapodiplomuar me diplomën *Master i Shkencave në "Shkenca Sportive"* të shoqëruar me Suplementin e saj.
7. Suplementi i diplomës hartohet në përputhje me kërkesat e Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë. Ai përshkruan, në veçanti, natyrën, nivelin, përmbajtjen dhe rezultatet e studimeve, që janë kryer nga mbajtësi i diplomës, si dhe fushën e punësimit. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës përcaktohen në statutin e UST-se, në përputhje me udhëzimet e ministrisë përgjegjëse për arsimin.
8. Në rast se studenti vlerësohet me notë jo-kaluese në mbrojtjen që i bën tezës së tij, ai mund të rimbrojë të njejtën tezë ose të mbrojë një tezë të re në një afati kohor të caktuar, por pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi.
9. Gjatë periudhës kohore maksimale të përcaktuar në kornizën ligjore në fuqi nga koha e përfundimit të studimeve të plota, diplomanti ka të drejtë të mbrojë tezën e tij deri në tre herë.
10. Nëse në të tre rastet diplomanti është vlerësuar nga komisioni me notë jo-kaluese ose ai nuk paraqitet për të bërë mbrojtjen e punimit brenda afateve maksimale, atëherë studenti humbet të drejtën e diplomimit.

KREU V

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 23

Kjo Rregullore e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” e shtrin veprimtarinë e saj duke filluar nga viti akademik 2022-2023.

Neni 24

Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” është objekt rishikimi periodik. Rishikimi bëhet në fillim të vitit të ri akademik dhe synon përmirësimin dhe përditësimin e elementëve të ndryshëm të saj. Rishikimi bëhet mbi bazën e propozimeve që mund të vijnë nga Koordinator i Programit të Studimit dhe Departamenti i Sporteve Kolektive, duke respektuar kuardin ligjor në fuqi, në Statutin e UST-se, Rregulloren e Pegitheshme, Rregulloren e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes, Rregulloren e Departamentit të Sporteve Kolektive, si dhe në këtë rregullore. Propozimet shqyrtohen dhe miratohen në Departamentin e Sporteve Kolektive dhe Fakultetin e Shkencave të Lëvizjes.

Neni 25

Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” është miratuar nga personeli akademik i Departamentit të Sporteve Kolektive.

Neni 26

Rregullorja e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” është miratuar në Dekanatin e Fakultetit të Shkencave të Lëvizjes.

Neni 27

Rregullorja e mëparshme e programit të studimit Master i Shkencave në “Shkenca Sportive” shfuqizohet.